



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

01 Numër: 68/2022
Data: 20.05.2022



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>
Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

Për: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 44.1, 42 dhe nenit 54.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010,

T H Ë R R A S

Mbledhjen e 4-të të rregullt të Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës. Mbledhja do të mbahet më: **31.05.2022, e Martë**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë në ora 10:00.

R E N D D I T E:

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit,
2. Arsytimi i mungesave në mbledhje,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të datës 29.04.2022,
4. Njoftimi me Raportin vjetor të punës NPL "Ambienti" për vitin 2021,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të ndarjeve buxhetore për tejkalimin e THV 1 2021,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim të bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga THV 2019,2020 dhe 2021,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Transferit nga Kategoria Ekonomike, 38 Rezerva në Kategorinë Ekonomike, 30-Shpenzime Kapitale,
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

KOMUNAL,
Vërejtje :

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje,
t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL.

KRYESUESI I KUVENDIT
Z. ENVER RUGOVA

Enver Rugova





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e Jashtëzakonshme të Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 31.03.2022, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------------|-----------------------------|
| 1. Enver Rugova, LDK; | 15. Ajshe Metaj, AAK; |
| 2. Hajrush Shoshi, LDK; | 16. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 3. Faruk Kabashi, LDK; | 17. Fjolla Ukaj, AAK; |
| 4. Haki Podrimaj, LDK; | 18. Negidet Ramaj, AAK; |
| 5. Ruzhdi Metaj, LDK; | 19. Florin Dreshaj, VV; |
| 6. Faik Alushaj, LDK; | 20. Niman Beqiraj, VV; |
| 7. Veton Kurtaj, LDK; | 21. Floriana Maxharraj, VV; |
| 8. Arta Balaj, LDK; | 22. Lavdiqe Bujupaj, VV; |
| 9. Njomza Demaj, LDK; | 23. Qerim Rexhaj, VV; |
| 10. Liridona Lajqi Avdiaj, LDK; | 24. Visar Haxhijaj, PDK; |
| 11. Valbona Demaj, LDK; | 25. Era Visoqi, PDK; |
| 12. Agron Gashi, AAK; | 26. Andi Xhuraj, PDK; |
| 13. Arianit Selmanaj, AAK; | 27. Melis Smakic, GIBI |
| 14. Nexhmedin Balaj, AAK; | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, Nënkryetari i komunës, përfaqësues të OSBE-së, zyrtar administrativ si dhe mediat lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i kuvendit, z. Enver Rugova – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.

Mbledhja e jashtëzakonshme është thirrur me kërkesën e 13^{të} anëtareve të Kuvendit të Komunës.

Procesverballi

Mbledhja është thirrur për shkak të mos bllokimit të punëve të Kuvendit të komunës së Istogut. Dhe në bashkëpunim me MAPL-në.

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes të gjithë (27) anëtarët e Kuvendit janë të pranishëm.

Vazhdojmë në mbledhjen :

R e n d d i t e

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit,
2. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
3. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara ,
4. Themelimi i Komitetit për politikë e Financa,
5. Themelimi i Komitetit për Komunitete,
6. Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB),
7. Formimi i grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.
8. Formimi i komisionit të aksionarëve për NK “ Stacioni i Autobusëve në Istog “.
9. Themelimi i Komisionit të aksionarëve për KRM “Ambienti” njësia në Istog,
10. Formimi i komisionit për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik Edukativo – Arsimit dhe aftësisë para universitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.
11. Formimi i komisionit për ndarjen e bursave,
12. Formimi i komisionit për ankesa ndaj ndarjes së bursave,
13. Formimi i Grupit të Grave Asambleiste ,
14. Formimi i Komitetit për Barazi Gjinore,
15. Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2021,
16. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021,
17. Shqyrtimi dhe miratimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës me qëllim të zhvillimit ekonomik në aspektin: lokal, urban dhe bujqësor sipas Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2022,
18. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës tuaj këtu të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës janë prezent 27 anëtar.

Florin Dreshaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, ne LVV prap mendojmë se ka shkelje të Rregulloreve kur na u janë servuar pikat e rendit të ditës me një material voluminoz të cilat duhet të kalohen së pari në Komitetin për Politikë e Financa dhe ne propozojmë që pikat 15,16, 17 dhe 18 të largohen nga rendi i ditës për sot.

Kryesuesi i Kuvendit – sqaron rrethe pikave të cekura, për piken e 17 ne kemi marr leje nga Ministria pasi qe sot është afati i fundit dhe duhet ta miratojmë listën e pronave .

Florin Dreshaj – ne konsiderojmë se me këto nuk mund të procedojmë sot sepse është një material shumë voluminoz nuk është faji jonë qe e keni pruar për tri ditë në mbledhje të jashtëzakonshme, është faji juaj që po tregoheni amater dhe nuk po mund me realizuar me afat të caktuar, as nuk keni formuar komitete as asgjë.

Kryesuesi i Kuvendit – sot i kemi në rend të ditës që te themelohen komitetet.

Hedh në miratim rendin e ditës

Për 15, kundër 5, dhe abstenim 7.

Konstaton se rendi i ditës u miratuar me 15 vota për.

Prezent në sallë 27 anëtar të Kuvendit.

Shqyrtimi i Pikëse 2

Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
Në mbledhje nuk mungon askush.
Prezent në sallë 27 anëtar të Kuvendit.

Shqyrtimi i Pikëse 3

Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara

Fjolla Ukaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, ne si grup parlamentar e konsiderojmë të jashtëligjshme seancën e fundit ku ne nuk kemi qenë pjesë e saj, pasi që në udhëzimin administrativ të MAPL-së nr.02/2015, neni 4 pika 9 thekson se vetëm kryetari i komunës mund të beje betimin pa qen kuorumi prezent çka nënkupton se në seancën e kaluar me betim kanë qen vetëm gjashtë ndërsa nënte kanë pasur ta dhëne betimin. Ti e ke cituar se ke pasur koordinim edhe me MAPL-në zyrën ligjore dhe të kanë udhëzuar që mund të vazhdash me kuorum i ke llogaritur edhe këta pa betim. Kërkoj që në cilin ligj ne cilin nene dhe në çfarë udhëzimi administrativ të kanë udhëzuar që mundesh me u bazuar.

Kryesuesi i Kuvendit – ju keni kërkuar interpretim ligjor në ministri dhe ne po presim përgjigjen nga ministria, me përgjigjen tuaj do të njoftohemi edhe ne.

Hedh në votim,

Për 15, abstenim 12

Miratohem me 15 vota për Procesverbalet e mbledhjeve te kaluara.

Shqyrtimi i pikës 4.

Themelimi i Komitetit për politikë e Financa,

Kryesuesi i Kuvendit – lexon emrat e propozuar që do të jenë pjese e Komitetit për Politikë e Financa.

1. Enver Rugova , Kryesues i Kuvendit të Komunës, Kryesues,
2. Hajrush Shoshi, nga radhët e LDK-së, anëtar
3. Liridona Lajqi, nga radhët e LDK-së, anëtare,
4. Faruk Kabashi, nga radhët e LDK-së, anëtar,
5. Ardita Idrizaj , nga radhët e AAK-së, anëtare,
6. Ajshe Metaj, nga radhët e AAK-së, anëtare dhe
7. Niman Beqiraj, nga radhët e LVV-së, anëtar.

Hedh në votim, që Komiteti të ketë përbërjen prej 7 anëtarëve dhe me këta emra.
Miratohet unanim, Komiteti për politikë e Financa
Të pranishëm në mbledhje 26 anëtar të KK.

Shqyrtimi i pikë 5

Themelimi i Komitetit për Komunitete,
Kryesuesi i Kuvendit – lexon emrat e propozuar që do të jenë pjese e Komitetit për Komunitete:

1. Melis Smakic, nga radhët e GIBI, anëtar,
2. Dula Karishik , nga komiteti boshnjak , anëtar,
3. Afrim Istrefaj, nga radhët e komunitetit egjiptian, anëtar,
4. Radenko Belosevic, nga radhët e komunitetit serb, anëtar,
5. Arta Balaj, nga radhët e LDK-së, anëtare,
6. Nexhmedin Balaj, nga radhët e AAK-së, anëtar,
7. Lavdije Bujupaj , nga radhët e LVV-së, anëtar dhe

Hedh në votim, që Komiteti të ketë përbërjen prej 7 anëtarëve dhe me këta emra.
Miratohet me 26 vota për, dhe 1 abstenim, Komiteti për Komunitete
Të pranishëm në mbledhje të gjithë anëtar të KK.

Shqyrtimi i pikës 6.

Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB),
Kryesuesi i Kuvendit – ky është komitet i kryetarit edhe janë emrat të cilët caktohen nga kryetari i komunës emrat janë në listë

Hedh në votim,
Miratohet me 15 vota për, dhe 12 kundër, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB),
Të pranishëm në mbledhje 27 të gjithë anëtar të KK.

Shqyrtimi i pikës 7.

Formimi i grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.

Kryesuesi i Kuvendit – lexon emrat e propozuar që do të jenë pjese grupit punues:

- 1) Enver Rugova, Kryesues i Kuvendit Komunal, kryetar;
- 2) Arta Balaj, nga radhët e LDK-së, anëtar;
- 3) Nexhmedin Balaj , nga radhët e AAK-së, anëtar;
- 4) Florin Dreshaj, nga radhët e LVV-së, anëtare,
- 5) Visar Haxhijaj, nga radhët e PDK-së, anëtar;
- 6) Melis Smakic, nga radhët e GIBI-së, anëtar dhe
- 7) Arben Kabashi, nga ekzekutivi, anëtare.

Hedh në votim,

Miratohet unanim, me këta emra, grupi punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.

Të pranishëm në mbledhje të gjithë anëtar të KK.

Shqyrtimi i pikës 8

Formimi i komisionit të aksionarëve për NK “ Stacioni i Autobusëve në Istog “.

Kryesuesi i Kuvendit – lexon emrat e propozuar që do të jenë në këtë komision:

1. Abedin Kabashi, Drejtor i Shërbimeve Publike, kryesues,
2. Arta Balaj, nga Kuvendi, anëtare,
3. Negjdet Ramaj, nga Kuvendi, anëtar.

Hedh në votim,

Miratohet unanim, me këta emra, komisioni i aksionarëve për NK “ Stacioni i Autobusëve në Istog “

Të pranishëm në mbledhje të gjithë anëtar të KK.

Shqyrtimi i pikës 9

Themelimi i Komisionit të aksionarëve për KRM “Ambienti” njësia në Istog,

Kryesuesi i Kuvendit – lexon emrat e propozuar që do të jenë në këtë komision:

1. Abedin Kabashi, Drejtor i Shërbimeve Publike, kryesues,
2. Liridona Lajqi, nga Kuvendi, anëtare,
3. Arianit Selmanaj, nga Kuvendi, anëtar.

Hedh në votim,

Miratohet unanim, me këta emra, komisioni i aksionarëve për themelimin e Ndërmarrjes Komunale “Ambienti” në Istog.

Të pranishëm në mbledhje të gjithë anëtar të KK.

Shqyrtimi i pikës 10

Formimi i komisionit për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik Edukativo – Arsimor dhe aftësisë para universitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.

Kryesuesi i Kuvendit – lexon emrat e propozuar që do të jenë në këtë komision:

1. Naim Sadriu, Zyrtar nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Istogut, Kryesues i Komisionit;
2. Mimoza Kabashi, Drejtoreshë në Shkollën fillore “Martin Camaj” në Gurakoc, anëtare.
3. Një anëtar nga Ministra e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, (MASHTI).

Hajrush Shoshi – kryesues para votimit të caktohet afati pastaj i votojmë anëtares.

Ajshe Metaj – është mirë për ne për të gjithë edhe për intervistuesi le të ndërrohen për çdo vite ashtu siç e ki unë jam për ata.

Drejtori i Arsimit, Naim Behlulaj – përshëndet të pranishmit, Neni 6 paragrafi 3 nenparagrafi 3 pika 3.1 , 3.2 dhe 3.3 i Udhëzimit Administrativ nr.151/2020 detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik Edukativo – Arsimor dhe aftësisë para universitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.

Hedh në votim,

Miratohet unanim, me këta emra, komisioni për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik Edukativo – Arsimor dhe aftësisë para universitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.

Nga votimi largohet Faruk Kabashi për shkak të konfliktit të interesit.

Të pranishëm në mbledhje 26 anëtar të KK.

Shqyrtimi i pikës 11

Formimi i komisionit për ndarjen e bursave,

Kryesuesi i Kuvendit – lexon emrat e propozuar që do të jenë në këtë komision:

1. Naim Behlulaj, Drejtori i Drejtoratit për Arsim, Kryesues;
2. Njomza Demaj, nga radhët e LDK-së anëtare,
3. Agron Gashi, nga radhët e AAK-së anëtar,
4. Qerim Rexhaj, nga radhët e LVV-së anëtar,
5. Fabian Ferizaj, nga shoqëria civile anëtar.

Hedh në votim,

Miratohet unanim, me këta emra, komisioni i për ndarjen e bursave.

Të pranishëm në mbledhje 26 anëtar të KK.

Shqyrtimi i pikës 12

Formimi i komisionit për ankesa ndaj ndarjes së bursave,

Kryesuesi i Kuvendit – lexon emrat e propozuar që do të jenë në këtë komision:

1. Arben Kabashi, drejtor i drejtorisë së Administratës, kryesues,
2. Arta Balaj, nga radhët e LDKK-së, anëtare,
3. Arianit Selmanaj, nga radhët e AAK-së, anëtare,

Hedh në votim,

Miratohet unanim, me këta emra, komisioni i ankesave për ndarjen e bursave.

Të pranishëm në mbledhje 25 anëtar të KK.

Shqyrtimi i pikës 13

Formimi i Grupit të Grave Asambleiste ,

Kryesuesi i Kuvendit – ky është grupi i grave anëtare të kuvendit dhe në këtë grup zgjidhet kryesuesja e grupit dhe anëtarët tjerë.

Ajshe Metaj – mandatin e kaluar kam qen kryetare e GGA-së , kemi punuar te gjitha bashkë nuk kemi pasur ndasi politike kemi punuar në interes të te gjitha qytetarëve ne veçanti grave të komunës së Istogut.

Hedh në votim,

Miratohet unanim, me këta emra, Grupi i Grave Asamblistë.

Të pranishëm në mbledhje 26 anëtar të KK.

Shqyrtimi i pikës 14

Formimi i Komitetit për Barazi Gjinore,

Kryesuesi i Kuvendit – lexon emrat e propozuar që do të jenë në këtë komitet:

1. Faik Alushaj, anëtar nga radhët e LDK,
2. Fjolla Ukaj, anëtare nga radhët e AAK,
3. Floriana Maxharraj, anëtare nga radhët e LVV,
4. Arlinda Kurtaj, nga Udheheqese e Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete,
5. Lirie Demiri Sadikaj, anëtare nga shoqëria civile,

Hedh në votim,

Miratohet unanim, me këta emra, Komitetit për Barazi Gjinore .

Nga votimi largohen Veton Kurtaj për shkak të konfliktit të interesit.

Të pranishëm në mbledhje 26 anëtar të KK.

Shqyrtimi i pikës 15

Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2021,

Kryetari i Komunës – prezanton dhe sqaron Raportin.

Nimon Beqiraj – përshëndet te gjithë te pranishmit, pikat 15, 16, 17 dhe 18 ashtu siç e thamë edhe në fillim janë tema të cilat duhet të diskutohen edhe në Komitetin për Politikë e Financa, pra janë të një karakteri të rregullt dhe materiali nuk është i jashtëzakonshëm kështu që ju e sqaruar në fillim të jenë diskutime të vazhdueshme edhe me MAPL-në edhe në suaza ditore siç e thatë mirë po kështu keni thënë edhe mbledhjen e kaluar e cila u shpall e pavlefshme. Mbledhjen e kaluar kush ka pas faj MAPL-ja apo ju, edhe sot ne mendojmë që është e njëjta dhe nuk do të bëhemi pjese e shkeljes së rregullore së Kuvendit.

Kështu që për ne kjo seancë përfundon sot.

Nga mbledhja largohet Fjolla Ukaj AAK dhe Anëtarët e LVV

Kryesuesi i Kuvendit – pasi qe diçka tjetër nuk kemi kalojmë në piken tjetër të rendit të ditës.

Në mbledhje prezent 21 anëtar të Kuvendit të Komunës.

Shqyrtimi i pikës 16

Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021,

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës – prezanton dhe sqaron Raportin.

Pasi qe diçka tjetër nuk kemi kalojmë në piken tjetër të rendit të ditës.

Në mbledhje prezent 21 anëtar të Kuvendit të Komunës.

Shqyrtimi i pikës 17

Shqyrtimi dhe miratimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës me qëllim të zhvillimit ekonomik në aspektin: lokal, urban dhe bujqësor sipas Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2022,

Drejtori i drejtorisë Agon Dreshaj – prezanton dhe sqaron listën e pronave.

Hedh në votim,

Miratohet me 15 vota për dhe 6 abstenim, për dhënia në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës me qëllim të zhvillimit ekonomik në aspektin: lokal, urban dhe bujqësor sipas Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2022.

Të pranishëm në mbledhje 21 anëtar të KK.

Shqyrtimi i pikës 18

Pyetje nga anëtarët e Kuvendit të Komunës,

Anëtarët e Kuvendit të Komunës, parashtrojnë pyetje për ekzekutivin.

Agron Gashi – siguria në shkollë në shkollën e Gurrakocit hynë një qytetar (prind i një fëmije) dhe e rrahë fëmijën në korridorin e shkollës. A keni ndërmarr diçka për këtë rast?

Veton Kurti – a do të vazhdoj prapë programi me Cartias në shëndetësi ?

Visar Haxhijaj – (Pengesat në rrugë) policët e shtrire në Vrellë afër shkollës a mundeni me i vendos prape sepse janë të rrezikuar këmbësoret aty posaçërisht fëmijët?

Valbona Demaj – në shëndetësi, ka mungesë të filmave në rëngën në Istog.

Ajshe Metaj – çështja e Bustacioneve, të behet edhe në mburojë (forcim) i bustacioneve sepse një erë sado e vogël po i rrezon.

Në disa vende është pre asfalti dhe janë dëmtuar rrugët, a ka dikush kontratë ti rinovoj (mirëmbaj rrugët) ?

Të gjitha pyetjeve dhe shqetësimeve e anëtareve të Kuvendit i përgjigjet Kryetari dhe drejtorët përkatës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Enver Rugova - Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje.

Shpall mbledhjen e mbyllur mbledhjen .

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:55.

**Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj**

**Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova**



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e tretë e rregullt të Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **29.04.2022**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------------------|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 15. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 16. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 17. <u>Negdet Ramaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 18. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 19. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 20. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 7. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 21. <u>Lavdiye Bujupaj, VV;</u> |
| 8. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 22. <u>Qerim Rexhaj, VV;</u> |
| 9. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 23. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 10. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 24. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 11. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 25. <u>Andi Xhuraj, PDK;</u> |
| 12. <u>Arianit Selmanaj, AAK;</u> | 26. <u>Melis Smakic, GIBI</u> |
| 13. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> | |
| 14. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: nënkryetari i komunës, z. Ali Nimanaj, përfaqësues të OSBE-së, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i kuvendit, z. Enver Rugova – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Hapi punimet për mbledhjen e tretë të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes (26) anëtarë të Kuvendit janë të pranishëm.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R E N D D I T E

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit,
2. Arsytimi i mungesave në mbledhje,
3. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
4. Shqyrtimi dhe debatimi i raportit financiar për tre mujorin e tretë të vitit fiskal 2021,
5. Shqyrtimi dhe debatimi i raportit financiar për tre mujorin e katërt të vitit fiskal 2021
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit financiar për vitin fiskal 2021,
7. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar - Mars) të vitit 2022,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022,
9. Anulimi i Vendimit 001Nr.53/2021 i datës 31.05.2021 për dhënien në shfrytëzim me negociim pronën e komunës "AGRO PRODUCT – SH.P.K",
10. Anulimi i Vendimit 001Nr.33/2021 i datës 31.03.2021, për ndërrim-destinimin e pronës private bujqësore në ndërtimore
11. Anulimi i Vendimit 001Nr.34/2021 i datës 31.03.2021, për ndërrim-destinimin e pronës private bujqësore në ndërtimore,
12. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit 01 Nr. 210/2022 për shfuqizimin e Vendimit 01nr.27/2018 të datës 29.03.2018.,
13. Rishqyrtimi i vendimit të kuvendit të komunës 01 nr.51/2021 lidhur me destinimin për varreza të pronës së paluajtshme të komunës,
14. Shpallja në diskutim publik e Hartave Zonale në komunën e Istogut
15. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës tuaj këtu prezent janë 26 anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi i kuvendit- Ajshe Metaj e ka kërkuar fjalën.

Ajshe Metaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë e kam një pyetje fillimisht pa e miratuar rendin e ditës. Mbledhja që është mbajtur me datën 25.03.2022 e konfirmuar si mbledhje urgjente, kisha dashur ta di a është konfirmuar ligjshmëria e saj? Edhe e dyta po dua a di, pra sa e di unë edhe disa kolegë të mi kemi diskutuar në mbledhjen e kaluar, dhe në procesverbal nuk ka qenë asnjë fjalë, a kanë qenë a të pavlefshme fjalët tona që nuk janë regjistruar në procesverbal, apo si duket i ka marrë era, dhe për këtë arsye unë jam kundër miratimit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar, për shkak se mungojnë mendimet e mia. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit profesoreshë! Për vendimin e mbajtjes së mbledhjes urgjente, nuk kemi marrë ndonjë përgjigje nga MAPL-ja, ashtu siç e përcakton ligji, nëse nuk e kthen brenda afatit 2 javë, përgjigjen as pozitive as negative, ajo konsiderohet e konfirmuar si pozitive. Tashmë ka kaluar afati. d.m.th kemi hyrë në muajin e dytë dhe përgjigje nuk kemi marrë prej ministrisë, prej departamentit për monitorim, kështu që konsiderojmë që është e vlefshme ajo mbledhje që është mbajtur. Sa i përket procesverbalit tash për pak shkojmë te pika tretë e rendit të ditës dhe e debatojmë. Unë po ju pyes a ka edhe dikush tjetër vërejtje apo propozime të tjera rreth rendit të ditës? Ka propozim nënkryetari i komunës z. Ali Nimanaj. Urdhëro nënkryetar!

Nënkryetari i komunës- Ali Nimanaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Në mungesë të kryetarit të komunës, unë kam një pikë të veçantë për ta propozuar për ta futur në rend dite. Të nderuar anëtarë të Kuvendit, propozoj që si pikë të rendit të ditës të futet zgjedhja e nënkryetarit të komunës nga radhët e komuniteteve.

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit nënkryetar! Mua më duhet të procedoj tutje, me e hedh në votim propozimin e kryetarit të komunës që e paraqiti nënkryetari i komunës. Kush është që kjo pikë e rendit të ditës të futet në rend dite? Konstatoj se të pranishëm në votim ishin 25 anëtarë të kuvendit dhe në mënyrë unanime u votua që kjo pikë e propozuar të futet si pikë e rendit të ditës për mbledhjen e sotme. D.m.th kjo pikë shqyrtohet e fundit. Tani e hedh në votim rendin e ditës me pikën e propozuar, kush është për? Konstatoj që rendi i ditës për mbledhjen e sotme miratohet në mënyrë unanime nga 26 anëtarë të kuvendit, po aq sa janë prezent.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- në mbledhje të pranishëm janë 26 anëtarë të Kuvendit.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit- pasi që u konstatua që i kemi 26 anëtarë të Kuvendit prezent, sa i përket arsytimit të mungesave në mbledhje, e kemi një anëtare të Kuvendit Njomza Demaj, e cila është paraqitur që nuk mundet të marrë pjesë në mbledhje për shkaqe private të saj. Mua me duhet të ju njoftoj që edhe Njomza edhe të gjithë ju keni raste të tilla në të ardhmen, nëse keni ndonjë rast për shkaqe shëndetësore, nëse nuk lajmëroheni 3 muaj e humbni të drejtën e të qenurit anëtar i kuvendit komunal, kështu që duhet me ju paralajmëruar që penalizmi financiar ekziston, pra mëditjen nuk e merr anëtari i kuvendit edhe nëse lajmërohet.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i kuvendit- sa i përket kësaj pike, ne veç e patëm vërejtjen e profesoreshës Ajshe, unë e futi në konstatim kush ka vërejtje. Urdhëro Niman Beqiraj e ka fjalën.

Niman Beqiraj- përshëndet të gjithë anëtarët e kuvendit! Sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, edhe fjalimi i ynë kur jemi larguar nuk është cekur aty, thotë vetëm që jemi larguar nga salla, pra jo edhe arsyeja se pse kemi dalë.

Kryesuesi i kuvendit- dikush tjetër a e dëshiron fjalën? Florin Dreshaj është lajmëruar.

Florin Dreshaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! unë kisha propozuar që procesverbali në mbledhjen e ardhshme të sillet i pa censuruar. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- mirë Florin! Por edhe incizimi mundet me qenë jo i mirë, nuk e di na ka rastisur ashtu, po më vjen keq prej profesoreshës Ajshe, por të shënohen të gjitha ato se çka thuhet, është korrektësi e madhe edhe është detyrë edhe obligim ligjor që të shënohet çdo gjë thuhet. Urdhëro profesoreshë!

Ajshe Metaj- sa i përket incizimit, ajo se çka është folur, sa e di unë media lokale “RTV Fontana” e ka përcjellë dhe e ka transmetuar, tash nuk e di se për çfarë arsye nuk është shkruar procesverbal, “RTV Fontana” e ka transmetuar mbledhjen unë e kam parë, pra kjo nuk qëndron.

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit profesoreshë! Haki Podrimaj e ka kërkuar fjalën!

Haki Podrimaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Ka mangësi procesverbali, unë propozoj që të plotësohet, kësaj radhe të miratohet, por radhët tjera të jeni më të kujdesshëm dhe çka thuhet të shënohet, se ky procesverbal më tepër i ngjan një monologu se sa një procesverbal, kërkoj në radhët tjera të përmirësohet pra kësaj radhe të miratohet, që mos të kemi probleme.

Kryesuesi i kuvendit- Niman Beqiraj e ka kërkuar fjalën.

Niman Beqiraj- unë meqë askush prej anëtarëve të Kuvendit, nuk patën vërejtje komplet opozita janë kundër edhe disa nga pozita, kështu që nëse miratohet ky procesverbal të sillet në mbledhjen e radhës.

Kryesuesi i kuvendit- unë propozoj që si kryesues që ta hedhim në votim me vërejtje që duhet me i përmirësuar nga të gjithë ju që patët vërejtje, Ajshe Metaj, Niman Beqiraj, Florin Dreshaj dhe Haki Podrimaj, që të sillet i korrektuar komplet procesverbali edhe i kësaj mbledhje edhe i mbledhjes se kaluar, po shihet që ka vërejtje, po e hedhim në votim, faktikisht edhe unë po mendoj ashtu si po mendon Nimani, pra që procesverbali të vjen në mbledhjen e radhës i kompletuar dhe i korrektuar?

Konstatojmë se nga 26 anëtarë sa janë prezent në mbledhje, 20 anëtarë votuan për, 6 kundër dhe 0 abstenim.

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi i Kuvendit- sa i përket kësaj pike, për shkak që vitin e kaluar kanë qenë zgjedhjet, nuk kemi pasur mundësi me e bërë raportimin e dy tre mujorëve të viteve të fundit, tre mujorit të tretë dhe tre mujorit të katërt të vitit 2021. Kështu që nënkryetar fjala është për juve.

Nënkryetari i komunës- faleminderit për fjalën z. Kryesues! Sa i përket pikës Shqyrtimi dhe debatimi i raportit financiar për tre mujorin e tretë të vitit fiskal 2021, ftoj zyrtarin kryesor financiar ta marrë fjalën për elaborimin e kësaj pike.

Osman Sadikaj- përshëndet të gjithë të pranishmit dhe prezanton pikën shqyrtimin dhe debatimin e raportit financiar për tre mujorin e tretë të vitit fiskal 2021.

Nëse nuk ka diçka dikush, unë kisha vazhduar me pikën tjetër të rendit të ditës.

Kryesuesi i kuvendit- për shkak të aspektit të rregullsisë dhe në procesverbal, na duhet ta bëjmë prerjen dhe me vazhduar me pikën e pestë të rendit të ditës, por së pari ta hapim debatin për këtë pikë të rendit të ditës. A ka diskutime? Urdhëro Ajshe!

Ajshe Metaj- faleminderit kryesues! Unë isha ndërlidhur me vendet e punës, d.m.th ky trend ka qenë edhe nga mandati i kaluar, fare mirë dihen kushtet nëpër të cilat kemi kaluar, edhe sipas mandatit të kaluar nuk është lejuar që të plotësohen vendet e tjera të punës, p.sh. në administratë, mirëpo në arsim dhe shëndetësi nuk ka qenë e ndaluar të plotësohen vendet e punës, kështu që unë e pyes ekzekutivin me i marrë parasysh kushtet në të cilat jemi ne, pse ne të hezitojmë mos t'i plotësojmë vendet e punës meqenëse këto janë sipas ligjit, d.m.th nuk është asgjë jashtëligjore, ose që kontestohen diku. Unë kisha propozuar të plotësohen sa më parë, edhe tash në kushte të tjera, tash pandemia mund të konsiderojmë që është pothuajse në fund, edhe nuk ekzistojnë ato ndalesa për plotësim të stafit me punëtorë, fal gjendjes në të cilën jemi ne dhe kushteve, shtrenjtësimi që është bërë tashmë, njerëzit janë në halle, megjithatë qeveria qendrore ka bërë një lloj lëmoshe 100 euro për punëtorë të sektorit privat dhe publik, por shtrohet pyetja çka ndodhë me ata që nuk e marrin asnjë euro askund, kështu që unë e kisha paraparë të rrugës dhe ju kisha propozuar, që mundësisht sa më shumë dhe sa më shpejt që mundeni t'i shpallni konkurset t'i plotësoni vendet e punës, meqenëse ligji ekziston, pagat ndahen për ata, dhe nuk kanë pse të mbeten vendet e zbrazëta. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- Faleminderit profesoreshë! Hajrush Shoshi e ka fjalën.

Hajrush Shoshi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Desha t'i përgjigjem pak Ajshe, se në arsim asnjë vend i punës nuk është i lirë, numri i nxënësve po bie nga vitit në vit, prandaj janë duke u humbur vendet e punës, prandaj kemi diku 167 mësimdhënës tepër, në buxhetin në bazë të normave të cilat janë nga ministria e Arsimit. Prandaj nuk ka asnjë vend të lirë, këto nganjëherë mbesin më pak nganjëherë më shumë, vendet e punës nuk munden të shpiken, nuk mund të pranojmë mësimdhënës, nëse nuk ka ku të jap mësim.

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit Hajrush! Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj-unë e kam një përgjigje për ish-drejtorin e drejtorisë së Arsimit. Pasi që janë plotësuar vendet e punës, kur u njoftuam për ato vende të punës, edhe plotësimi i vendeve të punës, ka ndodhur me një shpejtësi jashtëzakonisht të madhe, nuk jemi në dijeni as për kohën as për mënyrën se si janë zgjedhur ata punëtorë, edhe si kanë ardhur në punë. Faktikisht unë vetëm kërkoj vlefshmëri, nëse ato vende të punës janë arrit me shpallje të rezultateve sa ma transparente. Ku dihet fare mirë se çdo kund, e sidomos në sektorin e arsimit, unë e kam një vërejtje jashtëzakonisht të madhe e di edhe drejtori mirë këtu, se transparencë rreth punësimit për punëtorë të arsimit nuk ka.

Kryesuesi i kuvendit- fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- dole pak prej temës Ajshe, nëse ka ndonjë vërejtje, janë organet tjera, asnjë konkurs nuk ka shkuar pa u hapur ankesat nga ata të cilët nuk kanë qenë të zgjedhur, ka shkuar edhe në gjykata, edhe në inspektorat të punës, prandaj nëse ka dikush diçka. Sa i përket vendeve të lira, ju siguroj se nuk ka pasur mundësi asnjë vend më tepër me e krijuar.

Kryesuesi i kuvendit- po bëj përjashtim, Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- veç edhe këtë herë, më sa i përket kësaj pike nuk flas. Unë e flas, edhe di që ka pasur ndikim edhe rreth punësimit, për arsye se, në shkollën time, me 17 tetor kanë qenë zgjedhjet, përnjëherë të hënën kanë ardhur tri mësuese, si me ateruar prej aeroplanit, ne kemi vërejtje për pjesën e punësimit. Unë po flas konkretisht e di mirë fort drejtori, nuk po flas për pikëpamje individuale, por e kam parë që nuk ka pasur transparencë. I them drejtorit edhe përmes juve, në të ardhmen me e bërë transparencën në pranimin e punëtorëve, le të shihet testi, mos të dërgohen shabllonët e testeve diku e di mirë drejtori, ky këtu, pra kisha dashur që për punësimin e punëtorëve të arsimit të respektohet lista e pritjes, si është në të gjitha komunat, nëse p.sh. dy vjet konkurron një punëtor edhe ai tjetri i duhet rregullisht me hy në test, edhe që prapë se prapë vjen dikush që ndoshta i plotëson kriteret po ka rrethana tjera e punësohet, këtë kisha dashur, nëse e kalon një punëtor tjetrin mos të testohet më të vendoset në listë pritëse dhe kur shpallen vendet e punës të plotësohet vendi. Le të jetë një arsyeshmëri, le të harrohet politika e vendeve të tjera, sepse në arsim nëse shkojmë me politika ne kemi degraduar, duhet me e përzgjedhur, ata fëmijë me u viktimizuar për shkak të një mësuesi të dobët nuk është në dobi as për pozitën as për opozitën as për secilin qytetarë. Faleminderit!

Hajrush Shoshi- ishte fjala për listën e pritjes. Listë të pritjes nuk ka.

Kryesuesi i kuvendit- ndonjë mbledhje tjetër e debatoni këtë, këto janë të administratës. Fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- faleminderit për fjalën, pak dolëm në një temë tjetër, unë e kam një vërejtje për materialin për këtë pikë të rendit të ditës nuk kemi mundur me e hap, d.m.th jemi privuar nga e drejta me kontribuar për këtë pikë të rendit të ditës, na u është dërguar shumë herë po nuk kemi mundur me e hap materialin, dhe ky prezantim tashmë po më duket shumë i mangët, për shkak se nuk kemi mundur me e shqyrtuar më herët dhe është hera e parë që po e shohim, edhe nuk e di tash në vazhdim, edhe prezantimi që është bërë a është me para a vetëm me përqindje, se kjo me përqindje po na del shumë pak. Edhe me ja u ndihmuar këtyre parafolësve, u tha që nuk ka pasur mungesa të të punësuarave, në gjimnazin “Haxhi Zeka” në Istog ku unë punoj, vitin 2021-2022 e kemi filluar me 4 profesorë mungesë, d.m.th afër 3 muaj kanë humbë orë, vetëm në gjimnaz. Pra nuk është e vërtetë që ka pasur punëtorë e nuk ka pasur vende të lira.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Florin!

Osman Sadikaj- unë po prezantoj para juve vetëm të dhëna që janë të sakta, si është gjendja e punësimit. Unë po kërkoj falje Florin, materiali është i mbledhur janë 4 pika të rendit të ditës, sigurisht dikush e ka Exel-in 2007 dikush 2013, ky këtu e ka 2019, sigurisht mundet me qenë ajo, se me e dërguar hapet, tash varet me çka keni provuar ta hapni, se në laptop hapet. A ka mundësi që si ta pranoni materialin të më kontaktoni menjëherë, e kam adresën jam në dispozicion çdoherë. Komunikoni me mua sa herë të dëshironi, nëse diçka nuk është në rregull, apo ndonjë informatë shtesë.

Kryesuesi i kuvendit- Florin, unë edhe njëherë ju kërkoj falje. E gjitha kjo është bërë sa i përket çështjes së dy mbledhjeve të fundit, edhe për Komitetin për Politikë dhe Financa, pra shkaku i vëllimit të madh të materialit, vërtetë kemi pasur probleme të të gjitha llojeve, i kemi thirrur edhe IT-në me na ndihmuar për me e dërguar materialin, po nuk ka pasur mundësi, kemi provuar edhe me e bërë materialin në mënyrë fizike, disa prej anëtarëve veç e kanë marrë edhe fizikisht për të qenë korrekt. Urdhëro fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- për t'i ikur kësaj, zakonisht programet e pakos Office janë me pagesë, kështu që çdo dokument duhet me e dërguar në PDF , e këtë e hap edhe ne telefon edhe ne laptop. Është praktikë e keqe me i dërguar fajllat në Exel se Exel editohet, pra mos me i dhënë mundësi askujt me e edituar, pra e dërgon në PDF dhe nuk mundesh ta editosh, hapet në të gjitha pajisjet dhe është falas.

Osman Sadikaj- unë e kam praktikuar që materialin ta dërgoj në Exel për shkak që të jepet mundësia që të punoni lirshëm në të, të bëni analiza, të kontrolloni, me e dërguar në PDF nuk mundeni asgjë të bëni në të, e unë kam dashur të jetë transparent e çdo qytetarë kur t'i publikojmë në webfaqe, dhe ta ketë mundësinë që të shoh çdo gjë, është tek raporti financiar një shabllon që është në Word, e kam bërë në Word se kam mundur ta bëj edhe në PDF, po këtu nuk mundeni të ndërhyjni asgjë.

Kryesuesi i kuvendit- Niman Beqiraj e ka kërkuar fjalën .

Niman Beqiraj- edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa ju kemi lajmëruar që e kemi pasur problemin e njëjtë, dhe jeni dakorduar që me na e dërguar në formën që ne mundemi me e hapur. E tha edhe Agroni punën e PDF-it që unë pajtohem me atë se mundet të hapet e herën tjetër me pas mundësi me e bërë një debat. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- këtë nuk kemi nevojë ta hedhim në votim. Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i kuvendit- d.m.th sa i përket kësaj pike, obligohemi nga dy ligje dhe Statuti i komunës që para juve dhe para qytetarëve të komunës së Istogut, të raportohen çdo tre mujor, edhe raporti final i vitit të kaluar. Urdhëro Osman, tre mujorin e katërt e ke.

Osman Sadikaj- prezanton pikën e rendit të ditës; shqyrtimi dhe debatimi i raportit financiar për tre mujorin e katërt të vitit fiskal 2021,

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit Osman! Fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- faleminderit kryesues! Unë vetëm isha kyçur tek suficiti, se u pa një vlerë bukur e madhe e të hollave që kanë shkuar në suficit, sidomos kur bëhet fjalë për projektet kapitale, d.m.th kjo është një mangësi dhe nëse diçka dështon, ne në shkollë themi që nëse planifikon gabim atëherë ke dështuar, që i bie se me i pas planifikuar më mirë projektet nuk kishin shkuar të gjitha këto të holla në suficit. Në suficit kanë shkuar pa dashur me e prek askënd, edhe në sektorin ku unë punoj kanë shkuar shumë të holla në suficit, ku dihet mirë d.m.th mos të kaloj në atë temën tjetër se komuna ka borxh, kaq. Po dua veç për këtë te projektet, projektet kapitale, tashmë kjo është në të kaluarën, në të ardhmen mos të përsëritet, mos të stërgjatën procedurat e prokurimit, por kur të planifikohet, mundësisht të realizohen programet, sepse të shkojnë mjetet dhe të humbasin në suficit është dhimbje e madhe, për këtë arsye. Ju faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit Ajshe! A ka dikush tjetër diçka? Florin Dreshaj e ka fjalën.

Florin Dreshaj- faleminderit kryesues! Unë vetëm shkurt, desha me e shpreh pakënaqësinë time, se ne e dimë që Istogu e ka buxhetin e vogël për investime kapitale, edhe me shkuar gjysmë milion në suficit është shumë. Ka shumë nevoja të qytetarëve që kanë mundur të kryhen me ato mjete në qoftë se do ishte bërë një planifikim më i mirë. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit Florin! Dikush tjetër a e dëshiron fjalën për diskutim rreth kësaj pike? Haki Podrimaj e ka fjalën.

Haki Podrimaj- është e dëmshme me shkuar të gjitha këto mjete në suficit, jemi të vetëdijshëm të gjithë, mirëpo prita prej jush me e jap një arsyetim, nuk janë shkuar të gjitha që janë planifikuar keq, është mirë me i planifikuar mirë, edhe me i realizuar të gjitha investimet kapitale, mirëpo e kemi edhe një problem tjetër, që në qendër atje, OSHP-ja, nuk është funksionale kështu që pothuajse çdo tender ka edhe ankesa, ato ankesa shkojnë lartë atje, shqyrtohen, deri sa nuk shqyrtohen t'i nuk ke të drejtë më me e organizuar atë projekt, kështu që shumica e tyre, kanë shkuar besoj si pasojë e asaj procedure që OSHP-ja nuk është e organizuar, nuk është funksionale, kështu që shpresoj që funksionon ajo, dhe në të ardhmen nuk shkon asnjë cent në suficit.

Kryesuesi i kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- faleminderit! Pra përveç suficitit prej gjysmë milioni që tashmë ne jemi të detyruar ta kthejmë, na e marrin ata pra buxheti i shtetit që kanë mundur me u përdor në Istog për projekte të ndryshme. Është shqetësim edhe vonesa në pagesa për operatorët ekonomik. Pra vonesa në pagesa për kompanitë që kanë kryer punë për komunën e Istogut, dhe si rezultat i kësaj ka pasur edhe shpenzime shtesë për përmbarues, për të cilën kemi pasur edhe për të diskutuar, pra punën e përmbaruesit. Pra kjo i ka dy anë negative, e para po ngadalësohet biznesi, po i përkeqësohet puna, kurse në anën tjetër ne po paguajmë përmbarues që është edhe një humbje tjetër shtesë, duke e pasur parasysh që kemi suficit prej gjysmë milioni. Pra edhe këtu kisha pasur qejf edhe një sqarim pak më në detaje. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- a ka edhe dikush diçka që dëshiron të debatojë. Po e shoh që nuk ka. Osman të lutem!

Osman Sadikaj- po e shihni një pjesë tjetër të tabelës që është e ndarë, burimi i financimit të grantit qeveritar dhe nga të hyrat vetanake. Kjo nga granti qeveritar, kjo shkon në suficit, projekte kapitale që shkojnë në suficit 339,940.00 euro, totali që shkon në suficit nga burimi i financimit granti qeveritar është 457,681.00 euro, tash të hyrat vetanake, shuma prej 132.000.00 euro që nuk është shpenzuar kthehet prapë në këtë vit. Pra ta kemi pak këtë sqarim, sa i përket shkuarjes mjeteve në suficit, pengesa që e kemi pasur në vitin e kaluar ka qenë shumë e ulët me i realizuar projektet, bile në fund kur kemi arritur te kjo shifër e suficitit, me e thënë të drejtën, kemi qenë të kënaqur se ka qenë rrezik të jetë edhe më e madhe, për arsye se së pari, se rishikim të buxhetit nuk po na lejon që dy vite qeveria, me ndërruar projekte kapitale është procedurë burokratike që duhet të shkojë në kuvend me përqindje mbi 15% të buxhetit nuk ke të drejtë me ja ndërruar një pozite buxhetin dhe shkon dy muaj, edhe në ministri të Financave, e kanë bërë një burokraci të madhe, janë tri sisteme elektronike që duhet me i futur të dhënat, me t'i pranuar pastaj me i sjellë në Kuvend. Kështu që ka edhe neglizhencë por në fund prej 2.300.000 euro kanë shkuar në suficit, nuk është dashur të shkojë ndoshta asnjë, po prej këtyre janë mbi 50% mbetje të projekteve, të cilat nuk ka pasur kohë as të ridestinohen as të shpenzohen. Prandaj po shpresojmë që këtë vit e kemi filluar mbarë e ngadalë prej fillimit dhe shpresojmë që suficit të jetë shumë i vogël. Sa i përket pjesës tjetër të këtyre kategorive ekonomike, është e vërtetë që e tha Ajshja nëpër shkolla në fund që kanë mbetur suficite, nga kategoria mallra dhe shërbime, i kanë pasur alokimet drejtorët, nuk e kanë bërë iniciimin e kërkesës për shpenzim, ato do t'i kontrollojmë këtë vit, për arsye, ja të ja u jap edhe një informacion, për këtë vit 2022 ministria e Financave e ka ndërruar sistemin e alokimeve, d.m.th tash ne duhet ta bëjmë sistemin e alokimeve të rrjedhjes së parasë muaj për muaj, çka nuk i shpenzon këtë muaj, kalojnë në muajin tjetër, duhet me bërë kërkesë të veçantë me t'i lejuar për t'i bartur në muajin e ardhshëm, më herët ka qenë, t'i ka alokuar tre muaj, e nuk të ka ngacmuar a i ke shpenzuar apo jo, këtë vit e kanë ndërruar sistemin për shkak të shkuarjes së shumë mjeteve në suficit. Me i ngrit kapacitetet e shpenzimit të parasë publike, neve na kanë obliguar dhe prandaj po na dalin shumë probleme, se tashmë edhe stafi nuk është i përgatitur për këtë punë, çdo muaj duhet të shkojmë ta bëjmë kërkesën e rrjedhjes së parasë aq sa ty të nevojitet, tani, nëse ti ke bërë kërkesë më shumë, ato mjete duhet për çdo muaj prapë, ku një ditë mundet të thotë edhe ministri nuk po ju nevojitkan edhe me na i marrë se ka të drejtë me ligj. Po këtë vit ja u kemi shpjeguar të gjithë drejtorëve edhe kryetarit edhe nënkryetarit që këto rrethana na gjejnë këtë vit, sfida është duhet të punojmë. Këto janë sqarimet, unë prapë do të jem në dispozicion. Sa i përket përmbaruesëve në vitin 2020, kur ka përfunduar viti 2020, për shkak të Covid 19, buxheti i shtetit nuk ka mundur të inkasoj buxhetin e planifikuar dhe shumë prej 265.000.00 eurove që ne e kemi procesuar si shpenzim dhe që e ka paraqitur sistemi që është shpenzuar, me 5 janar të vitit 2021 ministria e Financave na thotë që këto mjete nuk kemi mundësi me ja u paguar për arsye se nuk ka të hyra në

buxhet, prandaj këto mjete paguani nga buxheti i vitit 2021. Çfarë ka ndodhur, procedura për t'i bërë këto pagesa kanë zgjatur, shumë operatorë nuk kanë pritur, dhe e kanë bërë kërkesën që kanë pasur të drejtë ministrisë së Financave dhe me përmbarues i kanë marrë ato mjete të cilat ne nuk kemi pasur asnjë faj, por nuk kemi pasur mundësi me ja u paguar, deri sa është dashur me e heq një projekt, me e fut një projekt, ai të ka thënë, vetëm merri paguaj prej vitit 2021, tani në deri sa është dashur ta përfundojmë atë procedurë, këta nuk kanë pritur pra bëhet fjalë për 260.000.00 euro, për pak e shihni atje tash e keni raportin vjetor që e shpjegon më në detaje. Ka edhe pjesë të tjera të cilat e kanë përfunduar punën, çështja e zotimit nuk ka qenë me kohë ka qenë një bllokadë e brendshme, por ata nuk po presin. Të ju them edhe një tjetër informacion, që ministria e Financave neni 40 i Ligjit të Menaxhimit të Parasë Publike, duhet paraprakisht me na pyetur neve, a ke borxh edhe ku dëshiron me t'i marrë. Ka bërë një dy herë pyetje dhe më nuk ka bërë, t'i merr dhe nuk të pyet fare, i shkruajmë email, nuk të përgjigjet asgjë, nuk t'i kthen mjetet dhe kaq. Kështu që po mendojmë që do t'i përmirësojmë këto gjëra.

Kryesuesi i kuvendit- Niman Beqiraj e ka fjalën.

Niman Beqiraj- pasi që ishim tek puna e këtij projektit te vazhdojmë, vetëm edhe një minutë e kam. Osmani e tha mirë dhe tamam e përmbloodhi atë se si ka ndodhur në të gjithë vitin neglizhenca, ju për shkak te neglizhencës na keni humbur 339,000.00 euro si investime kapitale, nëse ju e kishit parë prej 3 mujorit te dytë dhe të tretë që kanë me ju mbetur shumë mjete në suficit, keni mundur me e bërë ridestinimin e buxhetit, vet e the që deri në 15% të buxhetit ne kemi mundësi me e ridestinuuar, pse kjo pjesa e suficitit është më pak se 15%, kemi mundur ne me e ridestinuuar , në fakt me e bërë kërkesën sipas procedurave nëse ti merr dy muaj kohë le ti merr, por mos të humbin gjysmë milioni, për këtë punë jeni ju aty. Faleminderit!

Osman Sadikaj- së pari ta kemi të qartë që nuk thashë që kanë shkuar 339.000.00 euro në suficit për neglizhencë, e thashë shumë qartë që një pjesë e tyre kanë qenë mbetje te projekteve për arsye se kur po e hartojmë projektin, ne nuk po e kalkulojmë mirë sa ka me kushtuar një projekt, edhe kur te kalkulon projektin duhesh me e pasur një zyrë tamam profesionale me i pasur projektet në detaje qe me pasur mundësi me e ditur sa ka me kushtuar një projekt. Kur çmimi i tregut ndërron sikur tash që ka me ndodhur, asnjë organizatë buxhetore nuk ka me pasur mundësi me i përfunduar projektet të cilat i ka tash me atë çmim. Kështu që një pjesë është e teknikës, te lutem ta shpjegoj edhe këtë 15% po e zëmë që deri me 31 tetor është data e fundit e shpalljes se tenderit, edhe zotimet për kapitale tash kur ti po shpenzon të holla gradualisht e po të mbeten projekte, e thashë më parë për me bërë një kërkesë për ridestinim me 15% janë komiteti, kuvendi, është ministria, kërkesa, dy muaj ti merr, unë jam i vetëdijshëm qe ka me pasur prapë

raste, kemi me u ballafaquar me këtë problem, por ky është i sqaruar në detaje se pse ka ndodhur dhe si ka ndodhur. E thashë më herët që ne kemi qenë shumë të kënaqur në fund vit se kemi arritur në 339,000.00 euro në kapitale me shkuar në suficit, se ka pasur rrezik me shkuar edhe 700-800 mijë, por jemi angazhuar me aq sa kemi pasur mundësi, kjo është gjendja.

Kryesuesi i kuvendit- Niman me të vërtetë tashmë po kalon në dialog kjo. Hajde edhe këtë radhë, se në një lloj forme ti po i paraqet të gjeturat tua, përmbldhi pyetjet të lutem.

Niman Beqiraj- Osman ti veç e konfirmove atë se çfarë ne thamë, neglizhencë, se ti the nuk e kemi planifikuar mirë, tash kjo puna e planifikimit, le të jetë si punë e juaja në të ardhmen, që mos te ketë komuna e Istogut suficit, e me i humbur ne projektet. Pra me ekzekutivin e ri të mos bëhet gabimi i vjetër. Tash a i merr dy muaj kohë a nuk i merr, nuk ka rëndësi, ajo është procedurë që duhet të përfundohet, le të përfundohet por mos të humbin mjetet. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- Hajrush Shoshi e ka fjalën.

Hajrush Shoshi- desha vetëm pak rreth suficitit të diskutojë. Osman ndoshta ishte dashur me e sqaruar pak më shumë suficitin kur e dimë se vitin e kaluar 140,000.00 euro prej fondit rezervë, dhe nuk janë alokuar asnjë herë në buxhetin e komunës, d.m.th është një suficit që ne nuk kemi mundur me anashkaluar ose me e realizuar. Edhe projektet të cilat janë me OSHP edhe ato është dashur të pasqyrohen dhe te futen këtu, te dimë sa projekte i kemi në OSHP dhe nuk ke mundur ti të vazhdosh me procedura tjera. Ka pasur ridestinine të mjeteve prej projekti në projekt, prej mbetjeve, kemi pasur dy apo tri herë në këtë kuvend komunal , janë bërë ridestinine, d.m.th janë plotësuar projektet e tjera të cilat kanë mbetur, ka edhe projekt që ka mbetur borxh, prandaj po të pasqyrohen të gjitha besoj që do ta kishin anëtarët e kuvendit një pasqyrë pak më të qartë, nuk është çështje që nuk ka pasur planifikim të mirë , por janë shumë rrethana të tjera të cilat e kanë dërguar te ky suficit.

Osman Sadikaj- Hajrush, janë njëqind argumente për me treguar pse ka ndodhur. Në kuadër të këtij 339,000.00 euro është edhe 140,000.00 euro i rezervës, edhe ai nuk ka mundur të procedohet gjatë vitit në projekte kapitale, e kemi kryer në Kuvend këtu, e kemi dërguar në ministri, na e kanë kthyer, e kemi kryer edhe njëherë, janë emrat edhe të projekteve, edhe të bartjes së mjeteve që nuk na ka kthyer, d.m.th në kuadër të këtij 339,000.00 euro është e vërtetë që është edhe 140,000.00 euro, po ai ka shkuar në suficit dhe kaq. Realiteti është që OSHP-ja nuk funksionon, por në fund prapë se prapë duam ta arsyetojmë, planifikimin e një projekti, në rrethana në të cilat jemi, tenderi po na tregon më

shtrenjtë, e kanë bërë kontratën më shumë se zotimi, kanë mbetur borxh, borxhin nuk ke pasur mundësi ta paguash, është shkuar me përmbarues edhe i ka marrë. Deri tani gjendja është kjo, ka mundur të jetë edhe më keq, po në anën tjetër i kemi shpëtuar edhe 350,000.00 euro se edhe këto kemi mundur me i pasur aty, por kur ka ardhur momenti me e bërë pagesën, e kemi paguar nga të hyrat vetanake, edhe i kemi shpëtuar.

Kryesuesi i kuvendit- a ka edhe dikush diçka të diskutoj për këtë pikë? Si duket nuk ka. Faleminderit, pra ky është vetëm raport dhe nuk votohet.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i kuvendit- nënkryetar fjala është për ju të procedoni më tutje me pikën e 6 të rendit të ditës 'Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit financiar për vitin fiskal 2021. Në një lloj mënyre këtu u eksploruan shumë pyetje, edhe nga zyrtari kryesor financiar, që kanë të bëjnë pikërisht me këtë pikë, por urdhëro na duhet me e paraqitur para anëtarëve të Kuvendit.

Nënkryetari i komunës- faleminderit kryesues! Atëherë ja kaloj prapë fjalën zyrtarit kryesor financiar ta prezantoj në pika të shkurtra Raportin financiar për vitin fiskal 2021. Besoj që të gjithë anëtarët e Kuvendit e kanë pasur materialin paraprakisht, kështu që e hedhim në shqyrtim e pastaj në miratim.

Osman Sadikaj- faleminderit nënkryetar! Osman Sadikaj vazhdon me prezantimin e pikës së rendit të ditës 'Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit financiar për vitin fiskal 2021.

Kryesuesi i kuvendit- unë e hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës. Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- faleminderit kryesues! Unë isha ndalur në dy pika në të gjitha këto raporte. Së pari kisha bërë pyetje, marrë parasysh, ujësjellësin e mbi vadës, që faktikisht bashkimi evropian i patë ndarë 5 milion euro për ta zgjidhur çështjen e ujësjellësit. Nuk e di deri ku ka shkuar puna, ndoshta ekzekutivi edhe komuna e dinë, por për neve nuk dihet deri kur ka shkuar puna. Edhe e kam edhe një fakt që për shkak të rritjes së pagave që neve na i kanë gjuajt pagat këtu, kanë qenë 500,000.00 euro, dhe mandatura e kaluar 250,000.00 euro i kemi shfrytëzuar për rregullimin e rreth rrotullimit andej dhe 250,000.00 mijë patën shkuar te ujësjellësi. Dhe po më intereson, mjete po shkojnë mjaft por atje çfarë po bëhet, a mundet dikush me më dhënë përgjigje a jo. Edhe e dyta, borxhet që i ka komuna, ekziston një lloj laramani, se te punëtorët të cilët shkojnë në pension, disave ju paguhen tri paga menjëherë, e te disa të tjerë po duhet të shkohet përmes gjykatave, e pastaj me angazhuar përmbaruesin, pra siç e kam parë në tabelë, shuma e numrit të shpenzimeve të borxheve të komunës është rritur shumë herë,

për shkak se ato nuk kanë mundur të përfundohen nga arsyet që unë nuk i di, shumë punëtorë që kanë dalë në pension janë nëpër gjykata, ende presin me i marrë ato tri pagat e pensionit që ju takojnë secilit. D.m.th unë kisha një pyetje. Pse ne me ngec, përgjithësisht ju, kur e dimë që obligim e kem, edhe atë obligim duhet me e kryer, nuk duhet me prit p.sh deri në fund, sikur si e patëm edhe ne çështjen e arsimit që e përmendi zyrtari kryesor financiar, shumë herë e kam debatuar në këtë kuvend, edhe kur është planifikuar buxheti, kam thënë mundësisht planifikojeni këto mjete se ja keni borxh arsimtarëve sipas kontratës kolektive. Shpesh thoshit, jo e ka nënshkruar ai për qëllime elektorale, edhe po vjen puna që përmbaruesit tani po e këputin copën e vet, po i merr se po ja u merr, por për ju po rëndohet gjendja më shumë, për këtë ju kisha sugjeruar në të ardhmen, se kjo ishte çka ishte, borxhet mundësisht me i shlyer para se me ardhur përmbaruesi, se ai është i pamëshirshëm. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- dikush tjetër a e dëshiron fjalën? Florin Dreshaj urdhëro.

Florin Dreshaj- faleminderit! Unë së pari e pata një replikë me nënkryetarin, tha që të gjithë e keni pasur materialin, nënkryetar nuk e di a ishte më herët në mbledhje, një numër i madh i ynë, po ballafaqohet për herë të parë me këtë material, edhe nuk po e kemi mundësinë me i jep vërejtjet tona ndoshta edhe lëvdatat, se nuk kemi mundur ta bëjmë një analizë. Një pyetje e pata për zyrtarin kryesor financiar, tha që kemi mbi 87 milionë prona bujqësore, edhe ato prona punohen nga dikush, sa kemi të hyra nga këto prona?

Kryesuesi i kuvendit- nënkryetari e ka fjalën pastaj Osman e jap përgjigjen.

Nënkryetari i komunës- Florin, kjo puna e dërgimit të materialit, po besoj që është çështje e kuvendit, mirëpo, edhe në Komitet për Politikë e Financa, kemi diskutuar këtë problematikë, sepse anëtarët e Komitetit e kanë cekur që nuk ju ka shkuar materiali, ose nuk kanë mundur ta hapin materialin, aty është marrim vendim që të ju dërgohet edhe njëherë materialin në mënyrë që me e pasur të gjithë anëtarët e Kuvendit. Në bazë të informacionit që e kemi nga kryesuesi i Kuvendit dhe sekretaria, d.m.th materiali është dërguar, tash a është hapur apo jo, kjo ishte çështje që e diskutuam më herët prej aspektit ekzekutiv. Desha te pyetjet e profesoreshës të nderuar që i ceku në lidhje me shlyerjen e borxheve dhe obligimeve që janë sidomos me këtë kontratën kolektive çështjet e mësimdhënësve, unë po besoj që në bazë të takimeve që i kemi pasur edhe me bordin edhe me kryetarin, jemi zotuar që do të marrim parasysh gjitha këto dhe do të kemi edhe një planifikim më të mirë, në mënyrë që obligimet të cilat derivojnë dhe do t'i shlyejmë ato obligime, ne do jemi të vetëdijshëm ndaj kësaj edhe to të marrim masa paraprak që ne në mënyrë mos të kemi obligime të tjera. Ndërsa sa i përket ujësjellësit, kryetari i komunës nëse nuk gaboj para një muaji ka vazhduar edhe me aneksin tjetër që ka vazhduar me marrëveshje me kompaninë, në mënyrë që me u vazhduar edhe pjesët finale të mbylljes së rrjetit

të ujësjellësit, besoj që brenda një muaji apo dy, kjo pjesë do të duhet të përfundonte, kështu që d.m.th jemi në proces të finalizimit të ciklit të rrjetit të ujësjellësit për fshatrat e mbi vadës, në kuadër të kredisë që e kemi marrë për të siguruar ujë të pijes për qytetarët e mbi vadës. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit nënkryetar! Urdhëro Osman!

Osman Sadikaj- e pata edhe unë për profesoreshën, është e vërtetë që pjesët obligative, që janë tri pagat e arsimit dhe një jubilarë, tani në këtë vit kemi filluar rregullisht, çdo njërit që del në pension, është duke u zhvilluar procedurë dhe menjëherë është duke u bërë pagesa, dhe po shpresoj që ky obligim vetëm me përmbarues gati ju është përfunduar të gjithëve, se edhe në këtë vit na ka ekzekutuar përmes përmbaruesit thesari një pjesë të mjeteve për këtë obligim, dhe po shpresoj këto pjesa, po flas për tri pagat kur del në pension dhe një pagë jubilarë. Arsimi i ka tri paga të plota dhe një pagë të plotë jubilarë, edhe shëndetësia, ndërsa administrata i ka vetëm 25% të pagës jubilarë dhe një pagë në fund kur të del në pension. Pra këtë vit kemi filluar e di që kemi pasur probleme, a duhet me i paguar apo jo, a kemi obligim a jo, edhe pse ne të gjithë e dimë kontratën kolektive si shkruan në fund, ministria e Arsimit zotohet, që ne buxhetet e ardhshme me qarkore të veçantë të ndaj buxhet të veçantë për kontratat kolektive. Kështu që neve padrejtësisht po na marrin këto mjete, për të cilat realisht ne nuk kemi marrë obligim, ka marrë ministria. Borxhet të cilat i keni parë në pasqyrat financiare janë nga operatorët ekonomikë. Borxhet të cilat kanë qenë nga kjo për arsim dhe shëndetësi, po shpresoj që është në përfundim e sipër, nuk i kam të sakta të dhënat por po shpresoj që janë paguar të gjitha obligimet, pra kjo është sa i përket arsimit. Borxhet tjera që i keni në pasqyrat financiare, në këtë vit fiskal kemi filluar shumë vonë, për shkak se deri sa u konsoliduan, edhe deri sa në ministri të Financave e kemi bërë kërkesën për alokim, se tashmë është çdo muaj, kemi filluar shumë vonë me shpenzim, por tani jemi në fazën e kryerjes së obligimeve edhe nga viti i kaluar edhe këto që po dalin tani. Florin, ajo që the për material,

Florin Dreshaj- jo për materiali foli nënkryetari edhe pse nuk është e vërtetë se nuk na është dërguar asnjëherë më. Unë e pata një pyetje tjetër. Sa kemi të hyra nga tokat bujqësore që po krenohemi që kemi shumë?

Osman Sadikaj- pyetje me vend. Ka filluar vitin e kaluar, ka përfunduar edhe regjistrimi, edhe evidentimi i pronës, realisht për raport financiar e keni parë që ka zero të hyra nga taksa e tokës. Sigurisht që tani është duke u përgatitur strategjia se si me vepruar që kryetari me drejtorët duhet të përgatitin një strategji që të rregullohet dhe të kemi mundësi me krijuar të hyra.

Kryesuesi i kuvendit- drejtori i drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi z. Agon Dreshaj e ka fjalën.

Agon Dreshaj-përshëndet të gjithë të pranishmit! Prona bujqësore për qëllime bujqësore komuna nuk ka të dhëna në shfrytëzim, për këtë arsye të ardhurat prej tokave bujqësore janë zero. Për shkak se edhe vitin e kaluar nuk është zënë afati ligjor për listën e veçantë të pronave për dhënien në shfrytëzim. Këtë vit siç jeni dëshmitarë edhe ju e kemi zënë këtë afat, me 31 mars është votuar lista e veçantë e pronave, i kemi gjithsejtë 49 prona që i kemi në listën e veçantë për dhënien në shfrytëzim gjatë këtij viti, nëse arrijmë t'i japim këto prona edhe për qëllime bujqësore që janë afro 30 prej tyre, nëse arrijmë t'i japim, ka me qenë transparencë e plotë, kanë me qenë në dijeni të gjithë anëtarët e kuvendit dhe qytetarët, se kush po e merr pronën, sa është çmimi, dhe të gjitha raportet financiare, sa i ka të hyrat komuna, pra kanë me qenë publike. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- Florin, urdhëro veç po kalojmë në një lloj mënyre në dialog.

Florin Dreshaj- kryesues ne i kemi pyetjet që duam t'i dimë, nuk është punë e vogël kur prej këtyre pronave bujqësore, për çdo vit merren subvencione të majme, dhe dikush i punon ato toka, drejtori tha që kemi me i dhënë në shfrytëzim, por ato prona bujqësore janë të mbjellura me kultura bujqësore, edhe a e dimë ne se kush i ka mbjellë ato.

Kryesuesi i kuvendit- po e bëj një thirrje për të gjithë, me i përgatit pyetjet pak përpara, edhe i shqyrtojmë. Se faktikisht po penalizohen të tjerët, se sa herë ke të drejtë ta marrësh fjalën, se me Rregullore ke të drejtë një replikë me e bërë, edhe dy herë nga 5 minuta Florin, unë nuk po kam dëshirë të hyjë në këtë situatë tash. Drejtori i drejtorisë për Bujqësi e ka fjalën. Po kam dëshirë për transparencë, ja ku janë drejtorët dhe le ta ekzaminojnë situatën.

Astrit Hajrizaj- faleminderit kryesues! Përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa i përket pronave bujqësore, e pata një sqarim, se kjo është d.m.th evidentimi i pronave të veçanta bujqësore për të cilat planifikohen të jepen përmes ankandit në shfrytëzim në periudhën afatshkurtër prej 1-15 vite. Kjo i përket vitit të kaluar, nuk është për vitin 2022 është për vitin 2021, për shkak që kanë qenë zgjedhjet dhe afati i fundit ka qenë data 31 dhjetor, që të jepen në shfrytëzim këto prona, duhet të fillohet procedurë, të sillen në Kuvend, që ka qenë afati i fundit deri me 31 dhjetor, për shkak të zgjedhjeve ky afat është zgjatur dhe nëse nuk gabojmë ka qenë afati i fundit data 30 mars, i kemi evidentuar pronat, i kemi sjellë në Kuvend të fillohet procedurë, të jepen në shfrytëzim përmes ankandit. I nderuar profesor, sa i përket asaj që merren subvencione nuk merren sepse këto janë të bllokuara në sistem dhe janë pronë shoqërore, dhe evidentohen që askush nuk mundet të aplikoj për to.

Florin Dreshaj- ju po thoni diçka që nuk është. Tash vitin e fundit është ajo, po prej vitit 2021 e më përpara nuk ka qenë. D.m.th ato prona bujqësore janë duke u shfrytëzuar mbi 10 vite, dikush i shfrytëzon ato edhe merr subvencione, vitin e kaluar e dimë që i ka ndaluar qeveria, por deri atëherë i dimë edhe skandalet që kanë ndodhur me subvencione, pra dikush i shfrytëzon ato në mënyrë të zezë, ose këtu lind dyshimi që dikush prej komune merr dikush pare prej atyre që i shfrytëzojnë ato toka, e tash nëse ne e futim një pronë në ankand publik, edhe ajo pronë është e mbjellë me grurë, çfarë do bësh me atë tokë, kush do të shkoj e të konkurroj për atë tokë nëse dikush e ka mbjellë atë.

Astrit Hajrizaj- profesor, periudha për të cilën unë po flas, nuk po flas për një periudhë të së kaluarës por për periudhën në të cilën jemi tash. Nuk më takon dhe nuk mund të marrë përgjegjësi për një periudhë për të cilën nuk kam qenë, përmes ankandit mundet me aplikuar çdo kush, dhe askujt nuk mundesh me ja mohuar të drejtën. Nëse dikush ka të mbjella dhe nuk ka kontratë, për të cilën nuk paguan tatim komunës, ajo është e kundërligjshme dhe është shumë e qartë. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- Florin a je i kënaqur me përgjigje.

Florin Dreshaj- jam i kënaqur po unë nuk e akuzova drejtorin për asgjë personalisht, se tha nuk marrë përgjegjësi, por kjo është duke vazhduar, thuhet që nuk kanë marrë subvencione mirëpo kanë marrë.

Kryesuesi i kuvendit- vetëm mos të dalim nga tema, këtë më së miri është me e bërë pikë të rendit të ditës, dhe me e sjellë në Kuvend edhe me debatuar. Hajrush Shoshi e ka fjalën.

Hajrush Shoshi- desha vetëm një pyetje. Desha me pyet drejtorin se a është i njoftuar që vitin e kaluar është aprovuar një Rregullore që mund të jepen pronat komunale deri në një vit, i jap komuna pa ankand publik, pra kjo është mirë që të aplikohet, ndërsa kjo pjesa tjetër është procedurë tjetër që është edhe nëpërmjet ministrisë, këto zakonisht janë investime kapitale që do të investoj dikush në këto prona ose sera, ose ndonjë fabrikë. Prandaj është mirë që rregullorja e Kuvendit të filloj të vihet në funksion dhe të jepen pronat komunale. Sa i përket çështjeve të përparshme të jemi të qartë, e di edhe Florini që në fshat të tij ka me qindra hektarë tokë që nuk është punuar, në këto 5-6 vitet e fundit ka filluar të punohet toka, prandaj nëse dikush e ka punuar ne e dimë që nuk ka bërë ndonjë krim, por e ka bërë një përfitim, nuk e ka marrë tokën me vete, kemi plotë prona tonat që i japim falas, vetëm a dëshiron me i punuar dikush, është fat që ka filluar zhvillimi i bujqësisë, dhe të shfrytëzohet toka bujqësore. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- fjalën e ka drejtori Astrit Hajrizaj

Astrit Hajrizaj- faleminderit Hajrush për pyetjen. Në evidentimin e pronave bujqësore ne kemi rreth 87 prona që përfshinë diku rreth 600 hektarë që janë të evidentuara të jepen në shfrytëzim, por për shkak të volumit të madh, nuk ka qenë e mundur që të fillojmë procedurën për të gjitha përnjëherë dhe kemi filluar për 35 prona, dhe duke u bazuar shumë mirë se kam qenë vetë personalisht kur e kemi votuar Rregulloren për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba, pronat të cilat nuk janë të parapara në këtë moment që të fillojmë procedurat e nisjes së dhënies në shfrytëzim përmes ankandit këto jepen në shfrytëzim në periudhën më pak se një vit. Faleminderit besoj që jam shumë i qartë.

Kryesuesi i kuvendit- shumë faleminderit për sqarim. A ka edhe dikush diçka? Florin Dreshaj e ka fjalën.

Florin Dreshaj- ajo që janë qindra hektarë në fshat timin unë nuk po e di. Në fshat timin ka vetëm prona private. Ose që punohet që 5 vite toka, unë vet kam tokë edhe e punoj prej që kam lind, nuk është që 5 vite që ka filluar të punohet e para 5 vitesh nuk e ka punuar askush. Edhe i nderuar drejtor, unë më shumë e ngrita si çështje se keni me pasur probleme kur t'i futni në ankand publik, se dikush e ka mbjellë aty grurin dhe ata kanë me insistuar me marrë patjetër jashtë rregullave a çka po di unë. Faleminderit Florin! Niman Beqiraj e ka fjalën.

Niman Beqiraj- faleminderit kryesues! Për këtë raportin që po e debatojmë ka edhe mungesë transparencë, pra kemi përgjithësim të disa projekteve me një emër p.sh. rregullimi asfaltimi i rrugëve në Istog, rregullimi asfaltimi i rrugëve në Banjë, pra këto shumësi të rrugëve të cilat janë bërë kryesisht për fushata, e që ka pasur mundësi të mëdha me u keqpërdor, andaj unë kërkoj nga ekzekutivi i ri që të mos ndodhin më këto, të specifikohet se cila rrugë me emër dhe cilës lagje ju është ndërtuar rruga. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- për besë ky titullim i këtyre projekteve është e mundur që 10 vite që është, nuk besoj që ka qenë vetëm për vitin 2021 për fushatë, tash nuk po dua të hy vetëm në aspekte politike, po hyn edhe në buxhetet e tjera p.sh 2017-2019-2020 të njëjtat janë po të them me përgjegjësi të plotë.

Niman Beqiraj- në rregull kryesues në të ardhmen le të jetë si punë që të ketë transparencë edhe të thuhet cila rrugë është ndërtuar edhe në cilën lagje. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- Haki Podrimaj e ka fjalën.

Haki Podrimaj- kryesues desha të flas por kolegu që e përmendi, janë asfaltuar rrugët në Banjë, unë me përgjegjësi të plotë mundem të them që ja kemi filluar një lagjes të Gecajt që është, edhe nuk kemi shikuar asnjëherë në cilën parti është por me radhë ju kemi shtruar edhe atë lagje edhe të gjitha. Aty ka edhe komunitete ka edhe boshnjak edhe shqiptar besoni me kompetencë të plotë them që 50% nuk i kemi njohur po ja u kemi shtruar me radhë. D.m.th kemi pasur aq buxhet 50,000.00 euro me ato kemi shkuar dhe ja u kemi shtruar pra nuk qëndron ajo që e përmendi Banjën se unë vij nga ai lokalitet dhe nuk pajtohem me atë tezën e tij.

Kryesuesi i kuvendit- nënkryetari e ka fjalën.

Nënkryetari i komunës- Niman po besoj që këtë vit kërkesa juaj do të realizohet se edhe ne në raportin financiar do ta pasqyrojmë edhe më në detaje, se nuk kemi asgjë për të fshehur, shuma e buxhetit e cila shpenzohet për infrastrukturë është e paraparë, kërkohet detaje dhe për këtë punë zotohem që do ta keni më të detajuar. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit nënkryetar! Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- faleminderit kryesues! Kur është çështja e asfaltimeve është e vërtetë kolegu atë se çka po e thotë e kam parë. Por kur momenti kur janë shtruar ato rrugë, dhe në çfarë rrethanash kjo është një pikëpyetje.

Kryesuesi i kuvendit- Faleminderit! A ka dikush tjetër diçka? Po besoj që u shtjerua gjithçka nga ana jonë. Në bazë të ligjit këtu raporti financiar i vitit fiskal 2021 faktikisht ka dilema edhe në qeveri lartë dhe ligji fort nuk e precizon por e kemi bërë praktikë e hedhim në votim për miratim nuk ish dashur se është i kaluar në fakt, kush është për?

Konstatojmë që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm që jemi në votim miratohet raporti financiar i vitit fiskal 2021 me 14 vota për dhe me 10 vota të përmbajtura apo abstenime.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i kuvendit- sa i përket kësaj pike nënkryetar fjala është për ju.

Nënkryetari i komunës- faleminderit kryesues! Atëherë ja japim fjalën zyrtarit kryesor financiar që prapë ta bëjë një prezantim të raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar-Mars) të vitit 2022.

Osman Sadikaj- prezanton pikën e rendit të ditës shqyrtimi raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar-Mars) të vitit 2022.

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit Osman! Po e hap debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. A ka dikush diçka për diskutim? Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- nuk po dua të bëhem e tepërt këtu prej anëtarëve të tjerë me diskutuar, unë edhe pse e kam ngrit dorën e para, nuk ja privoj të drejtën e fjalës askujt. Prandaj pres prej kolegëve të tjerë, që mos të keqkuptohemi, për shkak se unë po i kam disa gjëra, e nëse dikush tjetër ka diçka unë pres. Vetëm një pyetje e kam. Te planifikimi i ndërtimit të tregut të ri zyrtar, i kam parë dy opsione kur janë ndarë 80,000.00 euro tash aty disa janë alokuar dhe nuk janë zotuar asnjë. Edhe një vend i kam parë 50,000.00 euro, janë me të njëjtin kod, a ke mundësi me më sqaruar se si është puna, a ka mundësi me u filluar diçka apo vetëm janë lënë gjërat në letër, si është puna?

Osman Sadikaj- ne i kemi dy burime të financimit, njëri është granti qeveritar njëra të hyrat vetanake. Disa projekte kapitale i kanë nga dy burime të financimit. Rasti konkret i tregut i ka nga të hyrat vetanake 50,000.00 euro dhe nga granti 80,000.00 euro. Por nuk di a e keni vërejtur aty që ai është shpenzuar, në këtë periudhë tash do të vjen raporti për muajin prill, d.m.th i ka marrë përmbaruesi 50,000.00 euro për çështje të arsimit. Ne i kemi edhe rezervat që janë 1.550.000.00 euro, ne e kemi debatuar edhe në Komitet edhe me drejtorët edhe me kryetarin, që nëse po kërcënohet kështu që të na marrin përmbaruesit obligimet ndaj kontratës kolektive duhet t'i lëmë disa mjete nga rezervat, për arsye se ligji na lejon nga rezervat t'i paguajmë obligimet eventuale që na vijnë. Këtë debat e kemi bërë, i kemi 770,000.00 të pa emëruara që kemi ruajt të hyra vetanake nga viti i kaluar pa i shpenzuar, i kemi paguar nga granti, dhe i kemi edhe një milion e gjysmë nga rezervat të cilat nuk janë të precizuara për çka kanë me u shpenzuar. Prandaj do ta keni rendin e ditës në mbledhjen e Majit ne detaje se çka do të planifikojmë për këto burime të financimit, të cilat ende nuk janë të planifikuara. Kompensimin e atyre projekteve që na ka marrë nga përmbaruesi do t'i kompensojmë me mjetet që do t'i ndajmë nga rezervat, edhe e mbushim prapë atë pjesën që na ka marrë përmbaruesi.

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit Osman! Urdhëro Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- unë po e kuptoj sqarimin, por qytetari nuk e kupton nëse e dëgjon si lajm prej dikujt, edhe thotë ku qenka vendi i tregut të ri, nuk e kemi parë, çfarë projekti ka, sipërfaqja sa do ta ketë koston, për këtë arsye e bëra atë pyetje se unë e kuptova, faleminderit për sqarim.

Osman Sadikaj- ende nuk ka filluar procedura, 130,000.00 euro janë të ndara për vitin 2022.

Kryesuesi i kuvendit- a ka edhe dikush që dëshiron të diskutoj? Siç duket nuk kemi më. Faleminderit zyrtarit kryesor financiar, nënkryetar dhe ju anëtarë të Kuvendit.

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i kuvendit- është shqyrtuar Plani i punës së Kuvendit nga komisioni i formuar, edhe pse me mangësi nga anëtarët prej të cilëve është përbërë, e kemi pasur kuorumin. Më duhet për transparencë dhe për ata të cilët nuk kanë qenë aty, me ju lajmëruar që ne edhe kemi rënë në dakord që në një lloj mënyre, që ta rregullojmë në aspekt mujor d.m.th ti inkorporojmë të gjitha atë mbledhje që janë mbajtur deri më sot. Edhe nga maji që d.m.th është inkorporuar edhe kjo mbledhje që është mbajtur sot me të gjitha pikat e rendit të ditës, që do t'i shtohet edhe kjo pikë që është e bazuar në bazë të ligjit. Materiali ju është dërguar, pra a ka dikush me e hap diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Lavdije Bujupaj e ka fjalën.

Lavdije Bujupaj-përshëndet të gjithë të pranishmit! Sot para vetes kemi Planin për hartimin e punës së Kuvendit për vitin 2022, një plan i punuar mirë nuk kam ndonjë vërejtje duke u bazuar që edhe grupi punues ka qenë i përzgjedhur nga njerëzit e përzgjedhur që e kanë bërë një punë të shkëlqyeshme, mirëpo kisha me u ndalur pak tek muaji qershor, ku në plan është e paraparë një vizitë studimore jashtë vendit me qëllim të shkëmbimit të përvojave të anëtarëve të Kuvendit komunal me një vend tjetër. Sigurisht edhe kryesuesi e di që në mandatet e kaluara po me të njëjtën pikë na ka ardhur Plani i punës, e fatkeqësisht vizita studimore nuk është realizuar, tash shpresoj në këtë mandat që kjo vizitë të realizohet me të vërtetë dhe të mos mbetet premtim në letër. Unë kaq kisha faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit Lavdije! Ke të drejtë po e dimë që dy vitet e fundit shkaku i pandemisë edhe vizitë studimore nëse parashihet në një shtet tjetër neve na duhet ta shikojmë edhe situatën e pandemisë si qëndron atje, ato kriteret shtetërore, p.sh nëse shkojmë në Shqipëri, Mal të Zi ose Maqedoni na duhet me i shikuar nuk po dua me thënë kur cilin muaj se frikësohem se na duhet me shkuar kur te them, por këtë e kemi parasysh edhe do t'i bëjmë edhe hulumtimet tjera, nuk është e thënë të shkojmë në një lloj mënyre të ja u kthejmë vizitën në Gramsh që e kërkonte kolegu Haki Podrimaj, po ne mundemi të shkojmë në ndonjë vend tjetër. Faleminderit! Urdhëro Lavdije.

Lavdiye Bujupaj- po kryesues ka qenë pandemia që dy tri vite, por në mandatin e parë kur unë kam ardhur si anëtare e Kuvendit nuk ka qenë pandemia. Sigurisht dihen rrethanat pse nuk është realizuar, unë shpresoj që tash për shkak të rrethanave tjera që i kemi do të realizohet. Faleminderit shumë!

Kryesuesi i kuvendit- Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- ka të drejtë kolegja, unë nuk kam qenë para dy mandateve, por mandatin e kaluar isha, dhe jo vetëm ne, por të gjithë ishin të pajtimit që të shkojmë dhe na ishte premtuar d.m.th për disa vite që kemi me shkuar, është e vërtetë që ka qenë pandemia, por ne nuk e kemi lënë për shkak të pandemisë se në fund u çliruam por u afrua fushata zgjedhore dhe kjo punë ra dhe e mori uji. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- Haki Podrimaj e ka fjalën.

Haki Podrimaj- e ke në 7 për muajin Maj shpallja në diskutim publik të plotësimit ndryshimit të Rregullores për transport publik dhe mallra, e ke të njëjtën po në atë muaj, shpallja në diskutim publik e projekt Rregullores për transport, pra kjo është e njëjta, njërën duhet me e heq dhe mos të figuroj në Plan të punës.

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit për pyetje! Kjo është shumë e drejtë, Rregulloren për transport urban edhe që inkorporohet edhe transporti ndër urban këtu, në një lloj mënyre ligji është në plotësim ndryshim edhe nuk është e thënë që ne i sjellim ato, nëse kërkon ligji, nëse ndryshohet diçka në ligj, si është duke ndryshuar Ligji për Vetëqeverisje Lokale, e ka kaluar leximin e dytë dhe vetëm pritet që të miratohet në Parlament, kështu që na duhet me qenë vigjilent edhe me i inkorporuar të gjitha ato si ndryshime që faktikisht bëhen në Parlamentin e Kosovës, me ligje të caktuara, kështu që ky vit ne së bashku me zyrën ligjore do të jemi shumë strikt në përcjelljen e këtyre plotësimeve ndryshimeve. Sa i përket asaj thotë në ligj edhe një Rregullore të ministrisë së transportit se tashmë kanë ndryshuar emrat e ministrive, edhe po ndryshojnë secila qeveri që po vjen, kështu që në një lloj mënyre të ligji thotë ashtu sepse kjo është për komunat e mëdha, për komunat e vogla është Rregullorja që e kemi mjaft të mirë që e kemi miratuar në vitin 2016, ke të drejtë për atë ne do ta heqim njërën, por kur vjen në shqyrtim, ajo do të varet prej ligjit në fuqi. Faleminderit!

Haki Podrimaj – këtu i ke paraparë të dyja, e për muajin qershor vetëm njërin, për atë arsye thashë që njërën me e heq, se kjo e para edhe për mallra edhe për transport kjo është e njëjtë.

Kryesuesi i kuvendit- jo unë po grupi punues. Dikush tjetër a dëshiron me e marrë fjalën rreth kësaj pike. Nuk është lajmëruar askush. Unë e hedh në votim

Planin e punës së Kuvendit komunal për vitin 2022. Kush është për?

Konstatohet se nga 22 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në votim në mënyrë unanime miratohet Plani i punës së Kuvendit komunal për vitin 2022.

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi i kuvendit- nënkryetar, fjala është për ju.

Nënkryetari i komunës- atëherë kryetari i komunës bazuar në nenin 58 pika h të Ligji për Vetëqeverisje Lokale i propozon Kuvendit të nxjerr vendim për anulimin e vendimit të Kuvendit të komunës 001Nr.53/2021 i datës 31.05.2021 për dhënien në shfrytëzim me negociim pronën e komunës “AGRO PRODUCT-SH.P.K”. Ky propozim vjen pas shkresës nga ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e cila nxjerr vendim dhe rekomandon se konfirmimin e ligjshmërisë vendimi i datës 31.05.2021 është vendim i jashtëligjshëm, pra Kuvendi i komunës ka nxjerr vendim të jashtëligjshëm dhe bazuar në këtë, kryetari i komunës i propozon Kuvendit që të anulohet ky vendim i datës 31.05.2021.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapim debatin rreth kësaj pike. A ka dikush që dëshiron të diskutojë? Hajrush Shoshi e ka kërkuar fjalën.

Hajrush Shoshi- unë e lexova këtë vendim dhe këtu nuk po thotë që është i jashtëligjshëm. Për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim, në këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me të cilën nuk parashihet shkëputja e kontratës, d.m.th nuk është paraparë shkëputja e kontratës për ndërrimin e afatit të dhënies në shfrytëzim të pronës nga dhënia në shfrytëzim afatshkurtër tek dhënia në shfrytëzim afatgjatë. D.m.th ka pasur problem me vendimin e jo që ka qenë i jashtëligjshëm, por është mbetur, nuk është shkëputur kontrata e parë, dhe për atë arsye e kanë sjellë me e shfuqizuar.

Nënkryetari i komunës- vetëm po dua edhe një sqarim. Vendimi si vendim kur e ka marrë Kuvendi, mënyra që i është propozuar nga kryetari, dhe Kuvendi që e ka marrë vendimin, ai vendim ka qenë i jashtëligjshëm, pikërisht për arsyen të cilën ti e ceke Hajrush. Por për më në detaje është drejtori i drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi i cili mundet me e prezantuar edhe më shumë.

Agon Dreshaj- përshëndet të gjithë të pranishmit, dhe prezanton pikën e rendit të ditës ‘anulimi i vendimit 001Nr.53/2021 i datës 31.05.2021 për dhënien në shfrytëzim me negociim pronën e komunës “AGRO PRODUCT-SH.P.K”.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- unë vetëm mendova që po tingëllon disi keq 'jashtëligjshëm' d.m.th ndoshta kishim mundur ta zbutim pra nuk është e jashtëligjshme.

Kryesuesi i kuvendit- Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- është e vërtetë që komuna ja ka pas dhënë për 15 vite, mirëpo në fakt siç e kam kuptuar unë ai ka kërkuar që edhe për 15 vite të tjera me bërë kontratë 30 vjeçare. A është kështu? Atëherë nëse është në tjetër pronë, është shumë e vërtetë, nuk po them që është e jashtëligjshme por duhet me u paraparë në kontratë, a duhet me u shkëput kontrata, apo në fakt nëse ishte dashur me u shkëput kontrata dhe për këtë arsye atij ja kanë kthyer d.m.th ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, unë kështu e kam kuptuar, përndryshe nëse ekziston ndonjë rrugë, marrë parasysh që "AGRO PRODUCT-SH.P.K" me Halit Avdijaj ka investime dhe zhvillim ekonomik dhe punësim të madh, por gjithmonë në suaza të ligjit nëse ka mundësi me ju krijuar ajo mundësi pse jo, por jo pa bazë ligjore e pa u konsultuar me zyrtar ligjor. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- Lavdije Bujupaj e ka fjalën.

Lavdije Bujupaj- desha vetëm një sqarim këtu me e dhënë se po më duket që edhe kolegët këtu nuk po janë në dijeni se çfarë është problemi kyç, dhe pse ka ardhur te anulimi i këtij vendimi. Të gjithë një pjesë të fajit e kemi edhe ne si anëtarë të Kuvendit këtu, sepse me datën 30.05.2021 ky vendim është votuar në këtë Kuvendit, andaj zona industriale me "AGRO PRODUCT-SH.P.K" me pronar Halit Avdijaj i ka ardhur urdhër nga ministria që të anulohet vendimi që është dhënë në këtë Kuvend me këtë datë. Ne si Vetëvendosje nuk kemi çka e përkrahim vendimin pasi është vendim nga ministria, patjetër që duhet me zbatuar dhe çfarë do që flasim është e tepërt, ani pse kompania në fjalë është kompani që ka pasur produktivitet në komunën tonë, shpresojmë që kjo të jetë procedurë dhe me e tejkaluar problemin në fjalë. Faleminderit Lavdije!

Kryesuesi i kuvendit- a dëshiron dikush të flas rreth kësaj pike. Drejtori i drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi e ka fjalën.

Agon Dreshaj- Profesoresha Ajshe e ngriti si çështje a mundet me ju mundësuar zgjerimi në biznes mbi bazën ligjore tash me vendim të ri. Atë e sqarova më herët me e zgjeruar biznesin për me e marrë atë pronë në shfrytëzim mbi bazën ligjore duhet me u shkëput ajo kontratë. Momentin që investitori interesohet tash prej fillimi për me e rregulluar këtë problem unë kam me qenë në funksion të tij që me e rregulluar, e vetmja mundësi ligjore pra është me e shkëput atë kontratë që me e bërë një kontratë të re, mundemi me negocim, për shkak se investimet e tij e

dimë sa e kapin vlerën ,sipas ligjit është 10% e investimit të investimeve kapitale të komunës për vitin paraprak vitin 2021, që mesa di unë është diku 3 milion euro investime kapitale 2021, dhe investitori i plotëson këto kriterë. Faleminderit!

Ajshe Metaj- d.m.th mua më interesoi drejtor a duhet drejtori të pres deri në vitin 2030 që me ju mundësuar ajo, apo ka afate më të shkurtra ligjore.

Agon Dreshaj- ka mundësi mos me e prit vitin 2030, për këtë arsye po them që mos me e prit vitin 2030, duhet me e shkëput atë kontratë që e ka valide deri në vitin 2030 që me lidhur kontratë të re.

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit drejtor dhe Ajshe! A ka dikush tjetër diçka në lidhje me këtë pikë? Si duke e kemi eksploruar në total çështjen problematike, nuk është e lehtë, me pasur mundësi e di që secili prej jush edhe ekzekutivi edhe ne këtu e mbështetim një biznes të tillë që saktë krenohet edhe Istogu edhe Kosova sepse na ka bërë edhe neve si Kosovë që të jemi në pozitën e shtatë në Evropë për trajtimin e bimëve aromatike-mjekuese edhe bio produkteve. Faleminderit për debatin, mua më duhet ta hedh në votim, kush është për?

Konstatojmë që nga 22 anëtarë të Kuvendit që janë të pranishëm, në mënyrë unanime u miratua pika e rendit të ditës ‘Anulimi i vendimit 001Nr.53/2021 i datës 31.05.2021 për dhënien në shfrytëzim me negociim pronën e komunës “AGRO PRODUCT-SH.P.K”.

Shqyrtimi i pikës 10.

Kryesuesi i Kuvendit- sa i përket kësaj pike fjala është për ju nënkryetar!

Nënkryetari i komunës- faleminderit kryesues! Gjithashtu edhe te kjo pikë kryetari i komunës bazuar në nenin 58 pika h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale i propozon Kuvendit që të nxjerr vendim për anulimin e vendimit të Kuvendit të komunës 001Nr.33/2021 i datës 31.03.2021 për ndërrim-destinimin e pronës private bujqësore në ndërtimore. Gjithashtu edhe kjo është çështje procedurale se është konfirmim për shkelje të ligjshmërisë, pra është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, dhe kur diçka është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi nuk e di çka mundet të jetë ndryshe pos i jashtëligjshëm. Për në detaje, ju besoj e keni pasur materialin, dhe ftoj drejtorin që edhe në këtë pikë ta bëjë një prezantim më të detajuar, ta keni një pasqyrim më të qartë edhe të keni mundësi të merrni vendim të drejtë. Faleminderit!

Agon Dreshaj- prezanton pikën e rendit të ditës ‘Anulimi i vendimit 001Nr.33/2021 i datës 31.03.2021 për ndërrim-destinimin e pronës private bujqësore në ndërtimore’

Kryesuesi i kuvendit- e hapim debatin. Kush është që të diskutoj rreth kësaj pike të rendit të ditës? Urdhëro Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- e kam shikuar këtë material, dhe e kam parë që neni 44 në arsyetim të ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal neni 44 pika 1, deri në nxjerrjen e planit hapësinor shfrytëzimi i tokës bujqësore për qëllime jo bujqësore mund të bëhet vetëm në bazë vendimit të Kuvendit komunal. Kuvendi komunal e ka marrë një vendim, unë nuk kisha qenë që ky vendim të anulohet se është i drejtë është i ligjshëm, vet ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal bie ndesh me këtë nen. Prandaj nuk ishte dashur që ne ti pranojmë të gjitha që i sjellë ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, sepse këtë nen në pjesën tjetër nuk e ka paraparë, për këtë sqarim do ishte dashur me e pasur një zyrtar ligjor, me treguar a është kjo valide apo nuk është. Neni 44 pika 1 vet ministria e ka shkruar, nëse dikush di ta interpretoj ndryshe urdhëroni, shiko edhe paragrafi 11.2, ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore mund të bëhet vetëm në pajtim me planin e rregullimit hapësinor dhe dispozitat e tjera të përcaktuara me ligj, dispozitë tjetër e përcaktuar me ligj është kjo, arsyeja me poshtë po bie ndesh me këtë nen.

Nënkryetari i komunës- unë vetëm po dua ta jap në parim çështjen e konfirmimit të ligjshmërisë d.m.th është ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, i cili është organ kompetent për me dhënë interpretime të tilla, nëse vjen nga një institucion më i lartë, është i thirrur, ne si institucion nuk kemi të drejtë me kundërshtuar në parim kundërshtimin e një vendimi, i cili është marrë nga një organ mbikëqyrës i cili është i thirrur për mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së punës së institucioneve lokale.

Hajrush Shoshi- nëse ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e ka anuluar një vendim, atëherë pse ne ta anulojmë, pse po kërkohet vota prej nesh? E ka anuluar ministria le të vazhdojnë procedurat, pse ne me e anuluar.

Nënkryetari i komunës- a bën edhe diçka të përgjigjem këtu. Kuvendi komunal si institucioni më i lartë përfaqësues legjitim merr vendime në këtë institucion, organ kolegjal. Vendimi është vlerësuar së është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi nga institucioni i cili na mbikëqyr neve, edhe për me e shfuqizuar atë vendim ka të drejtë vetëm ky organ i cili e ka nxjerrë atë vendim, ndërsa për bazën e ligjshmërisë të cilën ju po e kontestoni, e ka jap institucioni relevant që është i thirrur për këtë punë. Neve na mbetet a duam ta zbatojmë rekomandimin të cilin e ka dhënë ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që thotë Kuvendi ka nxjerr vendim kundërshtim me legjislacionin në fuqi, tash është çështje e juaja si anëtarë të Kuvendit për me marrë vendim apo jo. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- Valbonë Demaj e ka kërkuar fjalën.

Valbonë Demaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë desha veç një kërkesë me e bërë. a Bën që radhëve tjera pikat e rendit çka janë legjitime të vijnë në Kuvend e mos të biem ne pro e votimeve, pastaj jo e kthyen përgjigjen jo nuk është legjitime, sepse ne po biem ndesh me votën tonë që e kemi bërë paraprakisht. Zyrtari ligjor le ta marrë këtë iniciativë çka është e obligueshme dhe e drejtë të vjen në Kuvend. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- Florin Dreshaj është lajmëruar.

Florin Dreshaj- edhe unë në emër të Lëvizjes Vetëvendosje ju kisha bashkëngjit parafolëses, se po dalim edhe shumë keq edhe pse ne nuk kemi qenë anëtarë në atë kohë, shumë vendime po kthehen si të jashtëligjshme. Edhe me i shikuar dikush që e njeh ligjin se ne të gjithë juristë nuk jemi, ndoshta Hajrushit e di më mirë, edhe para se me i fut në lajthitje anëtarët e kuvendit me qenë diçka që është e ligjshme, dhe në qoftë se është ajo që e tha Hajrushit do kishte qenë mirë me i bërë padi ministrisë nëse na kanë bërë diçka të padrejtë.

Kryesuesi i kuvendit- Agron Gashi e ka fjalën.

Agron Gashi- isha kyçur edhe unë në këtë temë, si e thanë edhe parafolësit, Hajrushit është edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, me i debatuar aty edhe me shikuar e mos me na sjellë neve vendime, nëse e kanë votuar aty pro, nuk ka arsye pse me pasur kundërshtime më, nëse është ligji e ndjekim ligjin, nëse jo propozojeni me zyrtar ligjor e mos me na sjellë neve, se kur shkruan anulimi unë e di që është anulim i sigurt edhe e ngriti dorën, edhe në Komitetin për Politikë e Financa mos me na vënë në lajthitje, me u informuar më mirë e me qenë në dijeni se çka po votojmë. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- a ka edhe dikush që dëshiron të diskutoj rreth kësaj pike? Jo. Nënkrjetari a ke edhe diçka të shtosh?

Nënkrjetari i komunës- këto janë vendime që janë marrë në legjislaturën e kaluar, kështu është vlerësuar nga institucioni që e ka dhënë këtë vlerësim, ne do të përpiqemi që në të ardhmen çdo rekomandim që vjen t'i eliminojmë këto shkelje procedurale të cilat kanë ndodhur eventualisht, në mënyrë që të kemi sa më pak konfirmime të vendimeve që munden me qenë ndesh me ligjin ose të jashtëligjshme. Drejtor me herët e kërkoje fjalën, Dukagjin Hoxhaj, drejtor i drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis.

Dukagjin Hoxhaj-përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa i përket temës që patëm te ndërrimi i destinimit është e vërtetë që ka ardhur prej drejtorisë së Urbanizmit, por momentin që është votuar këtu ka shkuar në ligjshmëri. Ligjshmëria i ka

linjat e veta që e dërgon në kompetencë në ministrin e Planifikimit Hapësinor. Kur ne e kemi të aprovuar PZHK-në, PZHK-ja sipas ligjit është Planifikimi Hapësinor aty te parcelat është tokë bujqësore, d.m.th nuk është tokë ndërtimore, dhe për këtë arsye është kthyer ligjshmëria, që me e anuluar këtë vendim që është në kundërshtim me Planin Zhvillimor Komunal (PZHK). Faleminderit!

Hajrush Shoshi- mirëpo atëherë pse ky nen në ligj është aty? Pse nuk e heqin nenin edhe vazhdojnë procedurat, nëse nuk jam i qartë, e që nuk jam duke ditur ta lexoj, jeni të lirë ta thoni, mirëpo t'i heqin të gjitha të tjerat që ky nen nuk e lejon me e shfuqizuar, të tjerat mundemi t'i shfuqizojmë sa të doni, mirëpo ky nen nuk ta lejon me e shfuqizuar, nëse ka zyrtar ligjor edhe e interpreton ndryshe urdhëroni.

Nënkryetari i komunës- Faton, a ke ndonjë sqarim pasi që ke qenë më herët i përfshirë në çështjet e pronave si zyrtar ligjor.

Faton Bujupi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Hajrush këtu tek neni që po thirresh 44.1 thotë 'jepet në shfrytëzim përmes vendimit të Kuvendit të komunës' këtu nuk kemi të bëjmë me një vendime dhënie në shfrytëzim, por kemi të bëjmë me ndërrim destinimi, dhënia në shfrytëzim jepet përkohësisht kurse destinimi ndërrohet përherë. Ju i jeni referuar shkresës së ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal 44.1 thotë, deri në nxjerrjen e një plani hapësinor shfrytëzimi i tokës bujqësore por qëllime bujqësore mund të bëhet vetëm në bazë të vendimit të Kuvendit, por ne nuk kemi duke dhënë prona në shfrytëzim, vet titulli i vendimit është destinim. Këtu te rasti i vendimit të Kuvendit kemi të bëjmë me ndërrim destinim e ju po i referoheni shfrytëzimit.

Hajrush Shoshi- askush nuk po i referohet shfrytëzimit, shfrytëzimi i tokës bujqësore për qëllime tjera, për qëllime tjera, nuk ka qëllim tjetër pos me ndërtuar deri sa ta nxjerrësh Planin Hapësinor.

Kryesuesi i kuvendit- Hajrush le ta sqaroj njëherë Fatoni e pastaj e merr fjalën.

Faton Bujupi- Plani Zhvillimor Komunal 2018-2026 që është i miratuar në këtë Kuvend që besoj edhe ti ke qenë pjesë e këtij votimi thotë që kjo parcelë është destinuar si tokë bujqësore, pa u përfunduar ky plan nuk mundet të kthehet në tokë ndërtimore. Gjithçka është e qartë në shkresën e ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, pra kanë të drejtë. Plus është diskutuar edhe në Prishtinë ka qenë ish drejtori i Urbanizmit për këtë çështje.

Nënkryetari i komunës- Hajrush e ke nenin 11 paragrafi 11.4, po e lexoj decidivisht çfarë ka shkruar ministria 'tokës bujqësore nga neni 10.5 pika a dhe pika b nuk mund t'i ndërrohet destinimi dhe ajo nuk mund të filloj të përdoret për qëllime jo bujqësore nëse për atë rajon nuk është nxjerr Plani Hapësinor,

përkatësisht Plani Zhvillimor Komunal. Te arsyet e shkeljes është se komuna e Istogut, është mirë me i lexuar të gjithë paragrafët deri në fund në mënyrë që me e nxjerr pasqyrimin sepse ne nuk jemi me i ndërmarrë veprimet e caktuara që me i dëmtuar fermerët, qytetarët, operatorët ekonomik, ne jemi këtu me ju shërbyer atyre, veç me qenë transparent në atë që e themi deri në fund. Thotë nuk mundet nëse është i aprovuar Plani Zhvillimor Komunal, arsyet e shkeljes thotë që komuna e Istogut e ka të aprovuar Planin Zhvillimor Komunal për vitin 2018-2026 dhe në atë Plan është e destinuar prona, nuk mundet me ju ndërruar destinimi pronës sepse është e aprovuar. D.m.th këtë e ke te arsyetimi pas nenit 44 paragrafi 44.1, pra arsyeshmëria ta jep se ku është bërë shkelja që e ka bërë Kuvendi komunal, a është e qartë tani? Hajrush ju keni të drejtë asnjë mos me u pajtuar, është çështje e juaja që keni me e marrë vendimin, mirëpo po duam ta arsyetojmë para opinionit atë çka e ka nxjerrë ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, sepse këtu besoj nuk kemi dëshirë asnjë që kemi ardhur në këtë pozitë, që me i anuluar vendimet që janë marrë pikërisht nga ky organ.

Hajrush Shoshi- kjo dispozita tjetër është neni 44.

Nënkryetari i komunës- Hajrush nuk e lexove prapë, neni 11 paragrafi 11.4 te baza ligjore e vendimit që e ka nxjerrë ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Hajrush Shoshi- unë pajtohem me nenin 11.4 po të mos ishte vendimi i Kuvendit, po të mos ishte vendimi i Kuvendit nuk ka të drejtë me e shfrytëzuar si tokë ndërtimore, Kuvendi e ndryshon atë.

Nënkryetari i komunës- Hajrush, nëse nuk ka Plan Zhvillimor Komunal të aprovuar, Kuvendi nuk e ndërron nëse nuk e ke Planin Zhvillimor Komunal, hajt lexoje.

Hajrush Shoshi- po thotë deri në nxjerrjen e Planit të ri Hapësinor, shfrytëzimi i tokës bujqësore për qëllime jo bujqësore mund të bëhet vetëm në bazë të vendimit të Kuvendit komunal, Kuvendi komunal e ka marrë një vendim.

Nënkryetari i komunës- e ka marrë një vendim por ai vendim është në kundërshtim me Planin Zhvillimor Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit- nënkryetar dhe Hajrush nuk mundem me e lënë këtë dialog tuaj kështu para Kuvendit, a ka dikush tjetër për diskutim? Florin Dreshaj, urdhëro?

Florin Dreshaj- kisha propozuar me e hedh në votim, tash ne po dëshirojmë të dalim kundër vendimeve të ministrisë, se besoj që mundemi me dalë, ata janë

bazuar në disa ligje, në qoftë se mendojmë se i kanë shkel ligjet ata, mundemi me i paditur pse jo.

Kryesuesi i kuvendit- në rregull është faleminderit Florin! A ka më dikush tjetër rreth kësaj pike me diskutuar? Po më duket që e kemi eksploruar mjaftueshëm. E hedh në votim, kush është për që ky vendim të anulohet?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm, 18 për 1 kundër 1 abstenim u miratua pika e rendit të ditës 'Anulimi i vendimit 001Nr.33/2021 i datës 31.03.2021 për ndërrim-destinimin e pronës private bujqësore në ndërtimore'

Shqyrtimi i pikës 11.

Kryesuesi i kuvendit- sa i përket kësaj pike fjalën ja kaloj nënkryetarit të komunës.

Nënkryetari i komunës- ky është prapë vendimi i radhës që kryetari i komunës bazuar në nenin 58 pika h e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale i propozon Kuvendit të komunës që të nxjerr vendim për anulimin e vendimit të Kuvendit të komunës 001Nr.34/2021 i datës 31.03.2021 për ndërrim-destinimin e pronës private bujqësore në ndërtimore. Prapë ky propozim i kryetarit vjen bazuar në shkresat për konfirmimin e ligjshmërisë në nxjerrjen e vendimeve që e ka ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal i cili konfirmon që ky vendim ka qenë i jashtëligjshëm apo ka qenë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Faleminderit

Kryesuesi i kuvendit- e hapim diskutimin rreth kësaj pike të rendit të ditës. Është e njëjta si më parë. Urdhëro Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- kryesues mos prit vetëm fjalë që me të kritikuar. Unë vetëm desha mos me marrë kohë shumë meqenëse janë në të njëjtat rrethana, edhe është në kundërshtim për shkak se Plani Hapësinor është aprovuar, nuk lejohet destinimi i tokës bujqësore në ndërtimore, pasi që u votua të anulohet për të parin, e njëjta situatë është edhe për të dytin. Kaq kryesues.

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit Ajshe! Konstatoje kuorumin Florë. Tani jemi 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm. Kush është që të anulohet edhe ky vendim?

Konstatojmë që nga 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm, 20 për 0 kundër dhe 1 abstenim u miratua pika e rendit të ditës 'Anulimi i vendimit 001Nr.34/2021 i datës 31.03.2021 për ndërrim-destinimin e pronës private bujqësore në ndërtimore'

Shqyrtimi i pikës 12.

Kryesuesi i kuvendit- edhe për këtë pikë të rendit të ditës fjalën ja kaloj nënkryetarit të komunës.

Nënkryetari i komunës- faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të Kuvendit, gjithashtu kryetari i komunës bazuar në nenin 58 pika h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale i propozon Kuvendit të komunës që të nxjerrë vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të komunës 01Nr. 27/2018 të datës 29.03.2018. Shfuqizimi i këtij vendimi i cili është nxjerrë për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale për (15) pesëmbëdhjetë vite përmes ankandit publik operatorët ekonomik “TE ALENI” propozon që ky Kuvend të nxjerr vendim për anulimin e këtij vendimi mbi arsyeshmërinë e operatorit ekonomik i cili e ka paraqitur te zyra e Kryetarit, pra arsyeja është skadimi i licencës së punës për shfrytëzimin e gurit gëlqeror, dhe që dy vite në bazë të deklaramit të operatorit nuk ka mundur t’i shfrytëzoj këto parcela, dhe kërkon që të bëhet shkëputja e marrëveshjes me komunën që e ka. Të gjitha obligimet të cilat derivojnë deri në marrjen e këtij vendimi, operatori ekonomik obligohet që t’i përmbyllë ndaj komunës, kaq.

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit! E hapim debatin rreth kësaj pike. Kush dëshiron ta marrë fjalën? Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- edhe mandatin e kaluar e kemi pasur të njëjtën situatë, po tani ky vullnetarisht po e shpreh dëshirën me e shkëput kontratën, për shkak se nuk po dëshiron të vazhdoj më tutje. Po mua po më intereson a i ka kryer të gjitha obligimet ky operator ndaj komunës, edhe pasi ka shpreh dëshirë vet që ta shkëpus, edhe na po ja shkëputim. Unë po flas personalisht për vete, jam për me ja shkëput, vetëm a i ka kryer obligimet , prej kur, se ka kohë që po më duket e ka përmend me e shkëput, deri kur ka paguar, a i ka kryer saktësisht obligimet. Kaq.

Kryesuesi i kuvendit- urdhëro nënkryetar.

Nënkryetari i komunës- e ftoj drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi që ta jap sqarime shtesë.

Agon Dreshaj- po i sqaroj procedurat për shkak që siç e dini njëri prej bashkëpronarëve të kësaj kompanie është xhaxhai im, po dua ta deklaroj paraprakisht, por vetëm ta sqaroj procedurën. Kjo pronë është marrë me ankand në vitin 2018, qiraja vjetore i është paguar komunës edhe borxhi i kësaj qiraje vlen deri ditën e sotme, d.m.th sot nëse merr vendim Kuvendi me e shfuqizuar, operatori është i obliguar me paguar borxhin deri në ditën e sotme, nëse jo komuna ndërmerr masa disiplinore qoftë përmes përmbaruesit apo çfarëdo forme tjetër të nxjerrës të këtij borxhi. Edhe arsyeja e kërkesës së operatorit, siç e

dini për shkak të një vendimi dhe të ministrit të Infrastrukturës për një moratorium të licencave për shkak mos me e shfrytëzuar gurin gëlqeror, kjo është arsyeja pse e ka bërë kërkesën për me e shkëput kontratën për shkak se nuk mundet të hyj në funksion ajo parcelë. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit drejtor! Dikush tjetër a e dëshiron fjalën? Qerim Rexhaj është lajmëruar.

Qerim Rexhaj- kemi pasur vazhdimisht posaçërisht fshatrat Lubozhdë dhe Cerrcë. Dhe me thënë të drejtën, për mua dhe të tjerët ka qenë shumë e papranueshme, që një numër i këtyre kompanive veprimtarinë e tyre e organizojnë në fusha ku faktikisht është mjedis bujqësor, ku bëhet ndotja e ambientit, e kulturave bujqësore, ndotja e ujërave, e ajrit madje edhe rrezikimi i njerëzve nga bartja e zhavorrit përmes kamionëve. Çka d.m.th kjo, gurët merren në kodrina, ndërsa ata përpunohet në fusha, për mua është shumë e papranueshme. Prandaj dihet që në këto fshatra ka pasur edhe protesta edhe shkrime të petitionit dhe të cilat u janë drejtuar ministrive respektive dhe sipas informatave që kemi pasur ka dalë që një pjesë e këtyre kompanive nuk kanë as licencë pune, por kanë leje pune nga ana e komunës. Prandaj kisha kërkuar që në të ardhmen diçka kërkohet d.m.th duhet të respektohen edhe kushtet mjedisore, kushtet e banorëve dhe rrethanat ku do të kryhet përpunimi i këtyre inerteve dhe nuk ka askush asgjë kundër këtyre kompanive sepse të gjithë jemi dëshmitarë që këta edhe punësojnë njerëz edhe zhvillojnë ekonominë por natyrisht mjedisi është mbi të gjitha dhe kishte me qenë mirë me marrë parasysh këtë. Kaq.

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit profesor! Urdhëro nënkryetar.

Nënkryetari i komunës- sa i përket çështjeve mjedisore, po mendoj që kjo është një problem që jo vetëm në komunën tonë por edhe në plotë komuna tjera i shqetëson faktikisht kjo veprimtari, mirëpo kompetente për çështjet mjedisore është ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit nënkryetar! Haki Podrimaj e ka fjalën.

Haki Podrimaj- pasi ka bërë kërkesë operatori, unë jam pro asaj që kontratën të ja shkëputim, se besoj që edhe ai jo me dëshirën e vet, se me qejf do kishte me punuar se me e shkëputur kontratën, edhe në asamblenë e kaluar për disa prona kemi marrë vendim që nuk ka mundur t'i shfrytëzoj kështu që, i bashkëngjitem edhe koleges Ajshe, për obligime çka i ka, pasi ka ardhur propozimi prej kryetarit, kryetari pastaj me të i përfundon obligimet edhe kështu që te ja plotësojmë këto kërkesën operatorit.

Kryesuesi i kuvendit- Pasi që nuk e dëshiron askush më fjalën e kisha hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Konstatojmë që nga 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në votim me 21 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim u miratua pika e rendit të ditës 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit 01 Nr.210/2022 për shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 27/2018 të datës 29.03.2018.

Shqyrtimi i pikës 13.

Kryesuesi i kuvendit- nënkryetar fjala është për ju.

Nënkryetari i komunës- faleminderit kryesues! Gjithashtu edhe këtu kryetari i komunës bazuar në nenin 58 pika h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale i propozon Kuvendit të komunës që të nxjerrë vendim për 'rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit të komunës 01 Nr.51/2021 lidhur me destinimin për varreza të pronës së paluajtshme të komunës. Edhe këtu kemi konfirmim të ligjshmërisë, mbi marrjen e vendimit nga Kuvendi i kaluar për çështjen e dhënies në shfrytëzim për varrezat në fshatin Vrellë. Këtu ka qenë vetëm tek terminologjia, për shkak se aty është dhënë në shfrytëzim, ndërsa për çështje të tilla duhet vetëm të destinohet dhe nuk ka nevojë të zhvillohen procedura tjera për dhënien e asaj prone, kështu që këtu ka nevojë të ndërrohet terminologjia e dhënies në shfrytëzim në destinim të pronës. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- e hapim debatin. Niman Beqiraj pastaj profesoresha Ajshe Metaj.

Niman Beqiraj- faleminderit kryesues! Pasi që unë vij nga fshati Vrellë, dhe e di që tri vite është bërë kërkesa për destinimin e tokës, tash ai gabimi që është bërë e ka kthyer projektin në pikën zero. Sot d.m.th ne kemi me e destinuar tokën për ato varreza, është urgjencë kështu që i ftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit me e votuar këtë, mirëpo në atë marrëveshjen që e ka bërë komuna, ose kërkesën që e ka bërë kryetari i fshatit atëherë në vitin 2019, unë propozoj që ai projekt të ndryshohet, te destinimi i mjeteve apo si ta them, te marrëveshja që e ka pasur për participim mes qytetarëve dhe komunës, pra ajo ka qenë një marrëveshje që qytetarët kanë pasur të participojnë me 20% të shumës i cili është llogarit prej 80-100 mijë euro i tërë projekti. Ne e shohim që sot ekonomitë familjare kanë shumë problem me arritur me i bërë në këtë krizë mjetet për me participuar, kështu që kjo është detyrë e komunës, dhe të merret parasysh në mbledhjen e ardhshme që vjen projekti, të largohet kjo pjesa e participimit dhe mos të jetë barrë për qytetarët, nuk po e kërkojmë si pjesë të luksit por për varreza. Faleminderit!

Ajshe Metaj- edhe në mandatin e kaluar janë shtjerrë mjaftë diskutimet lidhur me këtë rast, dhe ka qenë e domosdoshme edhe ne anëtarët e Kuvendit komunal të gjithë e kemi votuar, marrë parasysh që fshati Vrellë është ndër fshatrat më të mëdhenj, është e domosdoshme, sepse nuk kanë më hapësirë ku me i varrosur të vdekurit, ne e kemi pas ndarë atë parcelë, por aty brenda asaj parcele ka qenë një lloj mëdyshje që ne e kemi paraqitur, se mos të përfshihen tre pronarë brenda kufijve të asaj parcele, bile nëse më kujtohet mirë, nëse kam këtu kolegë që kemi qenë bashkë në mandatin e kaluar, i kemi pas ndarë 53 mijë euro nëse jam e saktë, pra tash nëse duhet me u anuluar kjo shtrohet pyetja si tha edhe kolegu paraprakisht se a vërtetë shkon situata në pikën zero. E atëherë pra duhet të mendohet për këto, jam veç për ata që me u bërë zgjidhja, nëse kthehet në pikën zero, atëherë çfarë të marrin vendim të gjithë propozoj edhe unë mos ti kundërshtoj. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- atëherë nëse nuk ka dikush diçka tjetër e hedhim në votim. Urdhëro nënkryetari!

Nënkryetari i komunës- sa i përket çështjes së projektit për investim d.m.th krijimin e infrastrukturës tek varrezat, e kemi diskutuar bashkërisht me kryetarin këtë çështje, dhe ne si komunë e kemi marrë përsipër që projekti të mund të financohet 100% nuk do të ketë bashkë-participim. Ndërsa sa i përket destinimit, kjo është çështje që vetëm duhet të ndërrohet terminologjia nga shfrytëzim në destinim, ne sot marrim vendim për destinim të pronës për çështjen e varrezave, ndërsa sa i përket projektit d.m.th komuna e merr përsipër që ta realizoj 100%.

Kryesuesi i kuvendit –urdhëro drejtor.

Agon Dreshaj- në propozimin që e ka bërë parashtruesi i kërkesës, parcela e komunës e cila përfshin një hektar e 60 ari, i ka brenda vetës edhe tri parcela tjera që janë private por jashtë këtyre, por nëse inkorporohen edhe ato dhe arrijmë marrëveshje e kalon 2 hektarin. Në kuadër të kësaj unë e kam thirrur një mbledhje bashkë me propozuesin e kërkesës, bashkë me anëtarët e ekzekutivit që janë të zonës dhe me anëtarët e Kuvendit që janë edhe të pozitës edhe opozitës që janë këtu edhe e kemi mbajtur një takim, sot ne po e destinojmë vetëm pronën, në mbledhjen e ardhshme do të tentojmë që me siguri që kemi me arrit, me e sjellë si pikë të rendit të ditës ndarjen e mjeteve, tash i kemi kohë një muaj, ne e kemi jap dje në takim parashtruesit të kërkesës dy javë që me na sjellë marrëveshjen me këto parcela private para se ne me i ndarë mjetet, d.m.th nëse nuk arrijmë me e bërë, atëherë brenda dy jave tjera, komuna në bashkëpunim me ato palë, ka me i thirr dhe me e arritur një marrëveshje, momentin që t'i ndajmë mjetet kemi me e pasur të qartë se për sa jemi duke investuar. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit drejtor! Si duket çdo gjë është e qartë dhe e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është për?

Konstatojmë që nga 22 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në votim me 22 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim u miratua pika e rendit të ditës 'Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të komunës 01 Nr.51/2021 lidhur me destinimin për varreza të pronës së paluajtshme të komunës.

Shqyrtimi i pikës 14.

Kryesuesi i kuvendit- urdhëro nënkryetar, fjala është për juve.

Nënkryetari i komunës- faleminderit kryesues! Gjithashtu kryetari i komunës bazuar në nenin 58 pika h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale i propozon Kuvendit të komunës që të miratohet propozim-vendimi për vënien në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Hartës Zonale të komunës së Istogut për vitin 2022-2030. Me miratimin e këtij vendimi vihet në shqyrtim publik projekt-dokumenti Harta Zonale e komunës së Istogut për vitin 2022-2030. Rekomandim për vënien në shqyrtim publik të këtij dokumenti vjen nga ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit- e hapi debatin, kjo shkon në diskutim publik një muaj, ju kisha inkurajuar si anëtarë të Kuvendit. Urdhëro Hajrush.

Hajrush Shoshi- pasi që është në diskutim publik nuk do ishte dashur të hapim debat fare, kemi kohë një muaj të merremi dhe në fund kur të na vjen në Kuvend prapë atëherë diskutojmë për gjërat tjera, mirëpo është mirë që gjatë diskutimit publik të angazhohen më shumë, të japin vërejtje sa më shumë kush çka ka për prona të ndryshme, ka interesa të bizneseve, janë shumë të rëndësishme Hartat Zonale.

Kryesuesi i kuvendit- pasi që askush nuk është lajmëruar, e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është për?

Konstatojmë që nga 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 21 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim u miratua pika e rendit të ditës 'Shpallja në diskutim publik e Hartave Zonale në komunën e Istogut.

Shqyrtimi i pikës 15.

Kryesuesi i kuvendit - këtu jemi në pikën që u votua pak më parë propozimi i kryetarit që të zgjidhet Nënkryetari për Komunitete në komunën e Istogut. Neni 61 pika 1 pika 3 e përcakton qartë Nënkryetarin për Komunitete, kështu që nënkryetar fjala është për ju nëse keni diçka.

Nënkryetari i komunës- jo vetëm me e prezantuar shkurt bazën ligjore të cilën e përmende edhe ti. Këtu d.m.th kryetari i komunës i propozon Kuvendit komunal për shkak se është procedurë që duhet me u votuar edhe nga Kuvendi komunal Nënkryetari për Komunitete, Istogut gjithmonë aspiron në respektimin e të drejtave të komuniteteve të jetë liderë në këtë fushë. Andaj me propozim të kryetarit të komunës, propozojmë që Nënkryetar i Komuniteteve të jetë Valmir Ramaj.

Kryesuesi i kuvendit- faleminderit nënkryetar! Mua më duhet të ja u sqaroj çështjen me Ligj për Vetëqeverisje lokale siç e parasheh çështjen e votimit pasi që kemi edhe të komuniteteve të tjera na duhet ta bëjmë në dy faza faktikisht, votojmë ne vetëm dhe Melis Smakic vetëm se ashtu e parasheh ligji. Urdhëro Qerim Rexhaj e ka fjalën.

Qerim Rexhaj- kishte me qenë e radhës një lloj biografie e shkurtër për personin që po na propozohet.

Kryesuesi i kuvendit- nuk e kemi biografinë profesor.

Agron Gashi- a është prezent këtu në mbledhje nënkryetari i propozuar?

Kryesuesi i kuvendit- jo nuk është prezent.

Agron Gashi- është një çështje shumë me rëndësi kryesues, po e bëjmë Nënkryetar për Komunitete me dalë me e dhënë një prezantim me e parë ne se kush është ai, se qytetarët kanë punë me të ndoshta, ka me ju shërbyer komuniteteve, nuk mundet ai të qëndroj në shtëpi e me u bërë nënkryetar këtu. Shumë absurde.

Kryesuesi i kuvendit- Agron, ndoshta në shumë gjëra po pajtohem rreth kësaj, po tash mundet me u votuar propozimi i kryetarit direkt, shkon kjo në ministri për ligjshmëri, dy javë ai nuk do vjen askund, kur kalojnë dy javë, pajtohem që do ishte dashur pak me u prezantuar. Valbonë Demaj e ka fjalën.

Valbonë Demaj- kryesues desha vetëm një pyetje. Mandatin e kaluar i kemi pasur tre anëtarë minoritet serb dhe kanë propozuar për Nënkryetar të Komuniteteve dhe sa më duket mua përgjigja ishte që duhet me e plotësuar kushtet me qenë 10% i minoriteteve. A i plotëson kushtet me qenë 10% këtu me qenë Nënkryetar i Komuniteteve a jo, vetëm këtë pyetje e kam?

Kryesuesi i Kuvendit-Valbonë me ligj parashihet që të jenë 10% por ne siç e kemi shikuar, tash ato statistika a janë shumë të sakta nuk e di, 9.90% e diçka janë, nuk janë saktë 10% tash duam të jemi korrekt dhe transparentë këtu. Tash

shpërnguljet edhe ato me dokumente nuk bëhen të gjithë, unë nuk e di si është situata, nuk guxoj unë të jap prejudikim a diçka që nuk është e imja, por kjo është shifra e fundit që e kemi shikuar. Urdhëro profesoresha Ajshe.

Ajshe Metaj- është e vërtetë pajtohem me Valbonën se ashtu ka qenë kriteri se ne i kemi pasur këtu tre anëtarë të Kuvendit të komunitetit serb, edhe ata kanë kërkuar, çdo kush kërkon t'i realizoj të drejtat e veta pa marrë parasysh sepse ligji është në pyetje. Nëse për 0,0 diçka % nëse nuk e bën 10% ai nuk e plotëson kushtin. Prandaj unë këtu e ndaj votën pa marrë parasysh se kush është e çka është. Nëse nuk e ka plotësuar me ligj jam kundër.

Kryesuesi i kuvendit- nuk është e tyre se saktë ne kemi qenë këtu kur e kanë kërkuar nënkryetarin por ata kanë qenë të ardhur prej tri listave, tash me e shikuar minoriteti serb që janë në Istog është i fundit me numër, 100 e diçka banorë janë, edhe që kanë qenë anëtarë të Kuvendit këtu, tash rezident në komunën e Istogut me këtë që e përmenda janë komuniteti egjiptian më i madh, tani është komuniteti boshnjak, pastaj komuniteti serb e turk e të tjerë. Atyre nuk ju ka takuar fare, janë munduar me shfrytëzuar fuqinë e vet në Kuvend që e di mirë Ajshe ne të gjithë që kemi qenë në mandatin e kaluar si janë sjellë ata, edhe na kanë akuzuar që nuk i kemi mbajtur me projekte. Sa herë kanë propozuar projekte këtu Ajshe ata tre njerëz? Kanë ardhur janë nënshkruar dhe kanë dalë kanë ikur.

Valbonë Demaj- vetëm desha ta di a është ligjshmëri sepse po na kthehen vendimet, vetëm për ata pyeta se mandatin e kaluar nuk ju është lejuar, e thashë mos të bëjmë vendime prapë e me na kthyer ministria.

Kryesuesi i kuvendit- ke të drejtë. Nuk e ndalon edhe me qenë më pak se 10% nuk e sanksionon. Urdhëro Hajrush.

Hajrush Shoshi- kjo hyri si pikë e rendit të ditës, mirëpo asnjë material nuk e kemi marrë si anëtarë të Kuvendit, është dashur me na sjellë atë fletë të gjithëve e me e shpërndarë, nuk jemi duke mundur të kuptohemi, dikush po thotë është nënkryetari i komunës, dikush po thotë është nënkryetar i kuvendit. Sjelle vendimin ta lexojmë dy minuta bëni kopje 27 fletë e lexojmë pak.

Kryesuesi i kuvendit- nuk mundet kryetari ta marrë vendimin pa e votuar ne këtu Hajrush.

Hajrush Shoshi- propozim vendimi është dashur të jetë. Fotokopjo e na e sjellë.

Kryesuesi i kuvendit- Nexhmedin Balaj e ka fjalën pastaj Faruk Kabashi.

Nexhmedin Balaj- çfarë arsye ke ti me e shkel ligjin, as ne as ti.

Faruk Kabashi-përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë nuk po e kuptoj a po kërkohet prej nesh me e votuar nënkryetarin e kryetarit për komunitete, a na kërkohet neve se për Aliun nuk na ka pyetur fare. Unë po e di si zgjidhen ato, por në qoftë se kërkohet prej nesh me ja dhënë atë të drejtë për me e zgjedh nënkryetarin për komunitete, atëherë po e votojmë.

Kryesuesi i kuvendit- urdhëro Florin Dreshaj e ka fjalën.

Florin Dreshaj- dikush tha që duhet me e votuar, nuk ka asgjë duhet ne jemi të lirë me votuar për ose kundër, nuk mundemi me na detyruar. Kërkoj falje se paskam keqkuptuar, kishe po na detyroni që duhet me e votuar. Unë mendoj që kjo nuk duhet me kaluar dhe Lëvizja Vetëvendosje për këtë është kundër, për shkak se po e shohim sot sa vendimet u deshën me i kthyer që kemi gabuar. Edhe ne nuk jemi për me qenë pjesë e atyre shkeljeve të ligjit ose të rregulloreve siç doni ju, në qoftë se nuk i plotëson kriteret Istogu me pas Nënkyetari të Komuniteteve, deri tash ka funksionuar pa të. Lëvizja Vetëvendosje është kundër.

Agron Gashi- edhe ne jemi kundër për shkak të mënyrës, për shkak të ligjit, për shkak të votimit klandestin pa personin edhe nuk votojmë.

Kryesuesi i kuvendit- Haki Podrimaj e ka fjalën.

Haki Podrimaj- nuk do kishte qenë asgjë që me na sjellë një biografi, një fletë. Që thoni është jashtëligjore nuk është, mbi 10% e ke obligative, ti duhesh me e zgjedh, prandaj e ka paraparë kryetari për me e zgjedh një Nënkyetari të Komuniteteve nuk është gjë e dëmshme të zgjidhet një nënkryetari. Para kësaj asambleje ka qenë procedurë tjetër, i kemi pasur tre nga minoriteti serb. Unë jam pro me e votuar, e ka propozuar kryetari, ai ka punë me të, mirëpo radhëve tjera mos të tejkalohen këto gjëra, se çka të votoj kam dëshirë ta di.

Kryesuesi i kuvendit- kryetari pati punë në Prishtinë, se me ngulm i kam thënë me qenë prezent në mbledhje edhe me e prezantuar, po ju them sinqerisht.

Faruk Kabashi- mos të bëhem i tepërt. Ne a kemi me e bërë, apo a kemi me e votuar personin, kjo po më intereson mua, d.m.th deri tash nuk paska pasur Nënkyetari të Komuniteteve

Kryesuesi i kuvendit- jo nuk ka pasur.

Faruk Kabashi- e tash po duam ta bëjmë. Ne a po e votojmë që duam ta bëjmë, apo jemi duke e votuar personin? A mundemi me ma sqaruar.

Kryesuesi i kuvendit- po duam ta bëjmë.

Faruk Kabashi- ani është e drejtë e kryetarit me e zgjedh personin.

Kryesuesi i kuvendit- nuk bën direkt Faruk.

Faruk Kabashi- ma ja dhënë të drejtën.

Kryesuesi i kuvendit- unë po kam qejf për shkak të transparencës, para juve, edhe në emër të ekzekutivit, edhe në emër timin, unë nuk kam dëshirë ta shkeli ligjin. Kush është për?

Hajrush Shoshi- a ka mundësi një fletë me e pasur këtu? Edhe me e lexuar, nuk është shumë.

Kryesuesi i kuvendit- krejt çka bëhet është të shtyhet një muaj

Hajrush Shoshi- jo mos të shtyhet asnjë minutë. Shtype vendimin që e ka bërë.

Kryesuesi i kuvendit- po nuk e kam.

Hajrush Shoshi- ani trego kështu, që nuk e keni.

Kryesuesi i kuvendit- po unë nuk e kam, a dëshironi të ju gënjej?

Hajrush Shoshi- është e padrejtë me votuar në këtë mënyrë Kuvendi. Nuk e besoj që është dikush për që të votohet

Kryesuesi i kuvendit- unë ju kisha thirrur të gjithëve me e votuar. Kush është për?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 11 vota për 8 kundër dhe 1 abstenim zgjidhet Valmir Ramaj Nënkryetari i Komuniteteve.

Shqyrtimi i pikës 16.

Kryesuesi i kuvendit- mbledhjen e kaluar ka pasur mjaftë pyetje-përgjigje, ju kanë përgjigjur drejtorët e pranishëm këtu, tash me ligj është mbledhjen e ardhshme, unë e kam një propozim këtu nga anëtari i Kuvendit Negjdet Ramaj që i ka pyetjet për kryetarin e komunës, dhe unë do të procedoj si kryesues i Kuvendit, kryetari me kabinetin e tij do të ju jap përgjigje në mbledhjen e ardhshme, pyetjet e Negjdetit unë nuk dua ti lexoj, po duhet t'i paraqet kryetari së bashku me juve do të shqyrtohen në muajin e ardhshëm. E hapi debatin. A ka pyetje ?

Lavdiqe Bujupaj – kam dy pyetje të shkurtra e para ka të beje me qentë endacak, një problem permanent që është tash e ca vite në Kosovë dhe në komunën tonë ? A ka ndonjë hap konkret për eliminimin e këtij problemi? (pasi që të gjithë qytetarët jemi të rrezikuar e me shumë fëmijët tanë), numri i qenve endacak vetëm po rritet sepse të lagja e spitalit vetëm zbarkojnë qenë nga komunat tjera. Ju lus që të ndërmerrni një hap konkret, sepse është problem madhor. Në mandatin e kaluar e kemi pasur një projekt të mirë e kemi evituar sadopak problemin e qenve endacak mirëpo po shihet se ky si problem është në rritje. Lus ekzekutivin dhe nënkryetarin këtu që është i ri në pozitë, me ndërmarr edhe një hap apo në vazhdim të ndonjë projekti tjetër të ngjashëm me projektin që ka qenë me parë.

- Rruga "Ibrahim Rugova,, në qendër të qytetit tash e sa muaj ka ndaluar punimi i asaj rruge banorët e atyre bizneseve që punojnë dhe operojnë janë të shqetësuar dhe interesohen shumë me e ditë se kur ka me filluar vazhdimi i punimit të asaj rruge.

Ajshe Metaj – a mundet dikush me na informuar se çka ka ndodhur me inkubatorin e biznesit?

Banoret e fshatit Kashicë e kanë një shtëpi të kulturës dhe nga fshatarët nuk lejohen një pjesë të mbajnë aktivitetet në atë shtëpi, përjashtohen me arsyen sepse nuk kanë mundur të participojnë dhe ju ka ndaluar shfrytëzimi.

Kërkoj përgjigjen me shkrim.

Qerim Rexhaj – çfarë po ndërmerret nga Inspektoriati i komunës për respektimin e ndalimit të duhanit nëpër vendet publike?

Para disa viteve një kompani e arkitektëve të Urbanizmit nga Prishtina, e cila nga Komuna ka qenë e paguar përafërsisht me 10 mijë euro për përpilimin e planit urbanistik të qytetit të Istogut. Dua ta di se deri ku ka arritur të bëhet ky Urbanizim që e ka planifikuar ajo kompani, sepse në atë kohë është bukur para do viteve është paraparë që të bëhet një lloje trajektore prej Off-on-it e deri të fabrika e Fadofilit atje për me e bë shkarkimin e mjeteve në komunikacion.

Kuvendi Komunal ose drejtoria disa fshatra Cerrca, Lubozhda kanë mbetur pa u kyçur në sistemin e ujërave të zeza.

Që të ndërtohet një Lapidar memorial për të torturuarit, masakruarit dhe për të vrarit që janë bërë në Kullën e Popit, për të pushkatuarit në llugën e xhamisë, zabelin e Sadik Rexhëve, po ashtu dihet se një pjese e këtyre kufomave janë varrosur edhe në dy bunarë që njeri ka qenë në oborrin e shkollës fillore “Shtatëmbëdhjetë nëntori,, dhe tjetri në bunarin e kullës së popit, janë diku 400 (katërqind) të vrarë të cilët sot nuk kanë varrë as nuk kanë lapidar ku do të përkujtoheshin apo do të ju vihet se paku nga një tufë lulesh.

Problematika e ujit në fshatin Cerrcë, faktikisht një pjesë e mirë e tokave bujqësore ka mbetur mbi vadë si rezultat i marrjes dhe i keq përdorimit të ujit edhe nga bizneset edhe në futjen e ujërave për pije, prandaj në të ardhmen kisha propozuar që të ndërmerret të bëhet një plan për një rezervuar të ujit që të rezervohet gjatë dimrit në mënyre që të shfrytëzohet gjatë verës për ujitje. Për drejtorin e Bujqësisë, jemi dëshmitar të prerjes masive të pyjeve tona të shkatërrimit në masë edhe djegies për të humbur gjurmët e krimit që janë bërë aty . Dua ta di a ka ndonjë plan drejtoria e Bujqësisë kuptohet në bashkëpunim me ministrin, e mbjelljeve të fidanëve maleve tona me bimë të reja.

Ajshe Metaj – veç desha me u lidh me pyetjen që e tha profesori, edhe në mandatin e kaluar ka qenë temë edhe çështje me ish Kryetarin e patëm debatuar me e ngrit një përmendore aty ku kanë qenë shenjat e shtëpisë aty ku ju kanë humbur gjurmët se ajo shtëpi në fakt është vendi ku janë ekzekutuar shumë njerëz shumë shqiptarë në mesin e tyre është edhe gjyshi im, kështu që pa marrë parasysh se kush janë nuk ka qenë rendi me i hup emri, ne patëm vendos që me e ndërtuar aty përpara dhe e ndamë vendin aty ku ka qenë me kryetarin e mandatit të kaluar të ndjerë, kanë qenë 30 mijë euro të ndara për atë punë mirë po ato të holla pastaj nuk u shfrytëzuan për atë projekt po u destinuan për lapidarin ‘Ibrahim Rugova’ kështu ka qenë pa marrë nuk ka lidhje kjo pasi që është kryer diçka që nuk ka mundur me u përfunduar.

Por propozoj dhe i bashkëngjitëm profesorit Qerim, ne fal gjakut tyre jemi sot ku jemi dhe e meritojnë me pas emrin, një emër ose një vend ku mund t’i nderojmë ata që kanë shkuar në mënyrën me mizore, ndërhyra pak por mu ndërlidh se është çështje e mandatit të kaluar, nuk është bërë asgjë shpresoj që këtë mandat të punohet një lapidar, mos të harrohet e kaluara, se duke e harruar të kaluarën nuk mund të vazhdojmë shumë të ardhmen.

Kryesuesi i Kuvendit – ne kemi biseduar edhe me kryetarit aty do të ngritët një obelisk, sepse ka shumë njerëz aty të ekzekutuar, është bërë një ndër masakrat më të mëdha 90% të atyre njerëzve, nuk e dinë edhe ku janë varret atë e dimë të gjithë.

Agron Gashi – kam pyetje rreth sigurisë rrugore në qytetin e Istogut kam shumë pyetje nga banorët, sidomos banorëve në Rrugën “Hajzer Hajzeraj,, për policët e shtrirë, zona është ka shkolla fillore e tek stacioni edhe është kërkesë e tyre me i vendos edhe këta banorët, një lloj burokracie me i lajmëruar policin këshilli i sigurisë, drejtorët por nuk po kryhet puna, nuk është një çështje që kërkon shumë vonesë është çështja shumë e lehtë, ose tjetra se janë vendos e po hiqen faktikisht e ka vendos siguria se aty duhet të jete pengesa, nëse ka qenë dhe është hequr pse po rrinë një vit pa të, ti duhet të shkosh ta rregullosh ose me fol me drejtori të Shërbimeve Publike ,edhe duhet me pas kujdes mos me i dëmtuar ato. Është shenja ndalu pak mos të dëmtohen, të ndreqen pas një jave mos të anashkalohen ashtu flasë për rrugët përveç kërkesës së banorëve, ajo lagje është edhe rruga e shkollës fillore që është rrezik shumë i madh andej vijnë shumë shpejt, janë hequr pengesat, pasi siguria i ka vendos ato i ka pa të domosdoshme janë hequr rrinë një vit ashtu vetë bëhet dëm e kemi pasur rastin në qendër vetëm duhet me pas një me të madhe vitin e kaluar janë aksidentuar 2 – 3 fëmijë. Po flas për këto çështje se po vjen edhe sezoni i verës ne e dimë që rruga e qendrës është e bllokuar, ka me qenë një ngarkesë shumë e madhe këtu sidomos këtu të parku se vijnë 400 – 500 fëmijë e familjarë verës, është shumë problematike vera, bllokohet komunikacioni edhe këto çështje që janë aktuale me i rregulluar me shpejt se nuk ka nevojë me kërkesë se e ka përcaktuar siguria se duhet me qenë aty.

Po edhe kërkesat që po i bëjnë banorët mos me i vonuar shumë se po ndodhë ndonjë aksident është pjesë shumë e rrezikshme se po vijnë kamionët dhe po e shfrytëzojnë si transit, njihet si lagje se del direkt në rrugë , ndoshta z. Podrimaj e di se e ka dikun aty mund të del fëmija në rrugë është shumë e rrezikshme kjo është kërkesa e banorëve aty.

Kryesuesi i Kuvendit – nga përvoja Agron kam qenë drejtor i Shërbimeve Publike shumë kemi hequr me vendos pengesa me kërkesë të qytetarëve edhe nëpër shkolla që janë në një lloj mënyre edhe obligative dhe na lejon edhe ligji edhe nëse janë rrugë nacionale, edhe pse ne nuk kemi të drejtë me pas qasje në to por kryesisht këto kanë të bëjnë me vajtje ardhje.

Kryesisht dimrit po ndodhin edhe heqja e pengesave në rrugë, kompanitë për mirëmbajtjen e rrugëve po i heqin me kamionë, po ka probleme.

Janë në procedurë të tenderimit kompania për sinjalizim horizontal dhe vertikal ka qenë edhe vitin e kaluar bash kjo lënda ka qenë në OSHP.

Agron Gashi – për ata e propozova në qendër edhe të gjimnazi me qenë pengesat masive të betonit si nëpër qytetet tjera edhe këtu është siguria maksimale as nuk heqën as asgjë, nuk mund të dëmtohen edhe pse mos me ndaluar ne para shkollës se gjimnazit edhe këtu të parku se po vjen sezoni i verës dhe komunikacioni ngarkohet shumë edhe vitin e kaluar kemi pasur edhe aksidente.

Niman Beqiraj – salla e sportit në Vrellë gjatë fushatës ajo ja ka nisur me i vendosur ata drunjtë për me i mbuluar mirë por ata kanë mbetur tash në shi edhe nuk është ndërmarrë asgjë për me e vazhduar tjetrën. Unë kam frikën se ne si Istog nuk kemi aq përvojë me salla të sportit mos po na mbetet edhe kjo si salla që është ndërtuar aty të xhamia.

Kam një kërkesë prej banorëve të fshatit Drejë të cilët janë ankuar ose kanë kërkuar për një trotuar nga Zallqi deri në Drejë ku udhëtojnë fëmijët e tyre për me shkuar në shkollë në këmbë, është ajo rruga e drejtë për Prishtinë është rrugë e rrezikshme shumica e njerëzve veturat pothuajse i provojnë aty. Ose le të organizohet një kombi a diçka që paguhet prej komunës me i dërguar fëmijët në shkollë dhe anasjelltas deri sa të rregullohet çështja e trotuarit. Ndërkaq të pyetja tjetër dua një sqarim.

Salla e sportit në shkollën fillore ‘Bajram Curri’ në Istog a kanë të drejtë nxënësit e shkollës fillore me e përdorë atë sallë, shumica e prindër po ankohen se fëmijët nuk po lejohen me e përdor sallën për shkak se aty dikush mban kurse se duhet me paguar me hy aty.

Ardita Idrizaj – çka po ndodh me betonimin e kanalit në Lubozhdë në lagjen Idrizaj, edhe pse dy here e kemi propozuar e kemi votuar por nuk është kryer dua të di se çka po ndodhë?

Agron Gashi – vetëm desha për me e vërtetuar atë qe tha i nderuari Niman ku në Shkollën fillore “Bajram Curri,, në Istog fëmijët nuk i lejojnë me hy brenda temperatura -10C ata dalin luajnë jashtë unë nuk e di ku është arsyeja atë sallë e kanë shfrytëzuar edhe me herët për trajnime klube të ndryshme sportive, është absurde fëmijët me ardhur në shtëpi të djersitur në -10C në borë e në shi të djersitur me u kthyer në shtëpi e kam ngritur këtë çështje edhe para dy muajsh në Facebook, ajo sallë i ka të metat e veta se si është ndërtuar ka pikur i kam parë arsimtarët duke i qitur kofet kjo çështje tjetër, kjo sallë është punuar për fëmijë ekstra dhe kurrë nuk luhet me -10C . pasi që jemi në këtë temë edhe drejtoresha e drejtorisë për Rini Kulturë dhe Sport qenka këtu.

Palestra në Istog pasi që shkojmë shpesh me i përcjellë klubet tona sidomos të Basketit dhe Henbollit të vajzave, të punësohet dikush për mirëmbajtje sepse palestrat shkojnë dëm në këtë mënyrë, tualetet janë në gjendje të tmerrshme. Të gjitha palestrat në Kosovë janë të ruajtura, me e punësuar një punëtor dy ose tre për me e ruajtur atë palestër që 15 (pesëmbëdhjetë) vite jemi duke e pritur dhe pa mirëmbajtje ajo shkatërrohet.

Nexhmedin Balaj – kanalizimi në lagjen “Balaj,, ka stagnuar tash koha me ujit ne nuk ka kanalizim .

Florim Dreshaj – kjo për kryesuesin, kryesuesin që e kemi pasur para 6 apo 7 viteve na bënte një pauzë kur i kishim mbledhjet e gjata na sjellte edhe kafe.

Mbulimi medial i seancës nuk e di a keni marrëveshje me Radio Fontanen, por ata e lanë në gjysmë mbledhjen atëherë është dashur me qëndruar deri në fund në qoftë se paguhet.

Edhe kishte me qenë mirë që këtë pjesën e fundit drejtorët me qenë prezent, kurrë ma shumë drejtorë nuk kemi pasur, të pyetjet të jenë prezent, t'i marrin shënimet kemi drejtorë me bollëk kurrë nuk kemi pasur kaq shumë. Po i shohë nuk po ka vend në trapazan po edhe në divahane ka një here po ulen. Kish qenë mirë të jeni prezent kur kemi pyetje.

Agron Gashi – i kam edhe tri a katër pyetje po pasi që nuk janë drejtorët këtu po i bashkëngjitëm Florinit.

Ka drejtor që nuk e kam parë as një herë dhe po pres me ja bërë pyetjen, kështu me i treguar edhe kryetarit me qenë pak, një seancë në muaj me ardhur dy orë këtu.

Ardita idrizaj – edhe pse kryetari na pati premtuar që kanë me qenë deri në fund në mbledhjet e Kuvendit, por si duket nuk janë.

Kryesuesi i Kuvendit – nënkryetari është këtu ja adreson kryetarit ekzekutivit a ka edhe dikush diçka apo ti përgjigjem Florinit.

Florin, pikërisht së është Ramazan, se nuk është ndonjë shpenzim por nuk kam dashur ti prek njerëzit nuk e di kush është me Ramazan dhe kush pa Ramazan po e shohë nënkryetarin që nuk e ka nisur ujin, unë e kom pi edhe pikërisht është ajo se unë ata njerëzit që e agjërojnë për hir tyre nuk kam porosit kafe.

Ajshe Metaj - kam edhe një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, çështja e Bus stacioneve, era i gjuan herë kështu e herë ashtu, çka bëhet nuk e di është fjala për fshatin tim aty ka qenë para përmendores njëherë tani ka shkuar para një shitore aty të një fqinjë, tash e kanë sjellë në kokë të rrugës tonë si të fryn era ai menjëherë përmbysset është problem se rrezikon dikë është mirë të shikohen këto të ju bëhet baza edhe me i forcuar mirë janë në shërbim të qytetarëve, një erë sado e vogël po na rrëzon.

Kryesuesi i Kuvendit – është në procedurën e tenderimit. Shpresoj që do të rregullohen shpejt.

Kam edhe unë një pyetje për ekzekutivin të pompa e vjetër e karburanteve këtu që është mes qytetit 'Rr. Rinia' ka Gjumnazi nuk e di a e keni vërejtur shiritin që e kanë vendos, sipas informatave drejtori është këtu mbledhjen tjetër sille përgjigjen përgatite mirë dhe sille para këshilltarëve, e di se edhe tash mundesh por mbledhjen tjetër, nuk po dua të jenë prezent të gjithë këshilltarët.

Aty AKP-ja e ka jap atë me qira nuk po them me kopshtin e fëmijëve se ajo bashkëjeton prej 81-tës, edhe bashkëjetojnë ato që nuk është mirë fare, se është

afër çerdhes me as një parametër në rregull. Ne këtu në këtë Kuvend mandatin e kaluar e kemi votuar që të hiqet ai objekt nga aty. AKP -ja na ka ndaluar dashur që ta heq objektin nga aty Qeveria e re i ka bërë disa ndryshime aty ne si Komunë e Istogut kemi bashkëpunuar mirë me AKP-në deri tani dhe kemi me disa prona këtu që e kanë lejuar shembull këtu AKP-ja na ka lejuar 2017 - 2019. Kemi kryer edhe një serë punësh tjera se bashku me AKP-në kështu që ata e kanë dhënë në shfrytëzim.

Është pengesë për atë rreth rrotullim. Aty është baza kryesore ku shpërndahen në qytetin e Istogut. Aty ka shumë punë duhet të hiqen shtyllat e ndriçimit publik duhet me e heq trotuarin dhe duhet të bëhet qasja.

Ish pronari që e ka pasur atë në shfrytëzim pikërisht kur e kanë rregulluar rreth rrotullimin e ka shkëputur kontratën në gjysmë.

Kryesuesi I Kuvendit z. Enver Rugova - Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje!

Shpallë mbledhjen e mbyllur .

Mbledhja përfundoi me punë në ora 13:40

**Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj**

**Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova**



NDERMARRJA PUBLIKE LOKALE
KRM “AMBIENTI”
Njësia Operative – Istog

Nr:19 Data:21.01.2022

Për :

- **Z. Ilir Ferati – Kryetar i Komunës se Istogut**
- Asamblesë Komunale në Istog
- Komisionit të Aksionarëve , dhe
- Drejtoratit për punë komunale dhe shërbime publike

Nga :

- Ndërmarrja publike lokale “**Ambienti**” Istog

Lënda :

Raport pune i Ndërmarrjes Publike Lokale “**Ambienti**” ISTOG
Janar - Dhjetor / 2021

Hyrje

Ndërmarrja Publike Lokale “*Ambienti*” në Istog ,aktivitetin e vetë të gjithmbarshëm e ushtron në frymën e :

- Ligjit për menaxhimin e mbeturinave ;
- Ligjit mbi Ndërmarrjet publike ;
- Statutit të Ndërmarrjes ;
- Rregullorës Komunale për menaxhimin e mbeturinave
- Rregulloreve tjera të Ndërmarrjes “*Ambienti*”

Statusi :

Statuesi i Ndërmarrjes është akoma i pazgjidhur dhe Ndërmarrja funksionon si Njësi Rajonale e Mbeturinave me seli në Pejë dhe njëkohësisht si Ndërmarrje Publike Lokale deri në një vendim përfundimtar të Qeverisë që Ndërmarrjet e higjenës të kthehen nga Regjionale në Komunale.

Veprimtaria

Aktiviteti punëve që kryen Ndërmarrja e jonë kategorizohet në :

- **Primare dhe**
- **Sekondare**

Aktiviteti primar i Ndërmarrjes “*Ambienti*” në Istog ka të bëjë me : grumbullimin, bartjen dhe deponimin e mbeturinave shtepiake në Deponinë qendrore në Tugëp KK Istog, fshirjen, pastrimin e përditshëm të sipërfaqeve publike në Qytetin e Istogut si dhe herë pas here të qendrave urbane në Vrellë dhe Gurakoc, bartjen dhe deponimin e mbeturinave për në deponi nga Institutet e rëndësishme si nga : Burgu dhe FSK-ja në Dubravë të KK Istog

Aktiviteti sekondar i Ndërmarrjes “*Ambienti*” ka të bëjë me : larjen e sipërfaqeve publike sipas kërkesave të Inspektorëve komunal , mirëmbajtjen e gjelbrimit , pastrimin dhe eliminimin e mini deponive ilegale, mire-bajtja dhe pastrimi i borës në trotuarat e qytetit dhe objekteve të rëndësishme si veçant në sezonën e dimrit, pjesëmarrja aktive e fuqisë punëtore dhe mekanizmit me rastin e Aksioneve për rregullim të ambientit e punë të tjera që i përkasin veprimtarisë së Ndërmarrjes.

Shtirja gjeografike e veprimtarisë nga muaj Qershor është 98 % menaxhimi i mbeturinave. Si qytet dhe fshatra është 100% ,mos përfshiraj e 2 % në menaxhimi i mbeturinave është qasja e vështirë me makineri në terren të ndryshëm të teritorit në komunën e Istogut.

Struktura organizative

Nërmarrja është strukturuar në :

- **Spektori administrativ – shërbimet e përbashkëta dhe**
- **Spektori i operatives**

Në sektorin e shërbimeve të përbashkëta përfshihen : Menaxheri nga 01.07.2021 është me U.D menaxher , Zyrtari financiar(1) ,Arkatarja(1), Faturistja(1) , Inkasantet (5),Inspektori (1) dhe Pastrusja (1) , (gjithsejt 11) ndërsa në Sektorin e operatives : Menaxheri i Operatives (1),automekaniku(1), vozitësit (6) dhe punëtor fizik (16),Roje (2), qe gjithsejt punëtor të Ndërmarrjes janë 36 .

- Janë shqyrtuar kërkesa të qytetarve qe lidhen me shërbimet e ofruara nga kjo Ndermarrje si dhe ngarkesat e tyre me obligime ;
- Janë shqyrtuar edhe Regjistrat e obliguesve – borgjëlinjve të mëdhenj ndaj Ndermarrjes dhe është vendosur per procedure të mëtejme nëpërmjet Permbarusit Privat.
- Vendimi për zgjerim të rrjetit të veprimtarisë në zonat rurale ;
- Zgjerimi i veprimtarisë së grumbullimit të mbeturinave me thasë
- Vendime të tjera.

Në vitin 2021 ne muajin Dhjetor janë lëshuar këto fatura mujore:

1	Amvisëri	6026
2	Biznese	664
3	Institucione	46
4	Me kontrat	7
5	TOTALI	6743

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat e Inkasimit .Me Tvsh .
Tabela e Faturimit dhe Inkasimit me Tvsh per periudhen Janar –Dhjetor /2021

Nr	Kategoria e Klienteve	Faturimi	Inkasimi	Perqindja (%)
1.	Amvisëria	320834.27 €	324264.45 €	101.00
2.	Bizneset	101099.27 €	100199.79 €	99.11
3.	Institucionet	69891.59 €	76324.93 €	109.20
	TOTALI 1+2+3	491825.13 €	500789.17 €	101.82

SPECIFIKIMI I SHPENZIMEVE PËR PERIODËN JANAR-Dhjetor/ 2021

1	Shpenzimet e KEK	2209 €
2	Shpenzimet e IPKO-S	890 €
3	Shpenzimet e Naftës	54956 €
4	Shpenzimet e Vajrave	2842 €
5	Shpenzimet e provizio	485 €
6	Shpenzimet e PAGAVE	269148 €
7	Shpenzimet e marketingut	80 €
8	Shpenzimet e Autogomave	1674 €
10	Shpenzimet e reprezentacionit	791 €
11	Shpenzimet e Permbarusit	8849 €
12	Shpenzimet tjera (Deponia+tjera)	23322 €
13	Shpenzimet e Regjistrimit te Automjeteve	4327 €
14	Shpenzimet e mirëmbajtjes	47191 €
15	T O T A L I	416764 €

Sektori i operatives

Në këtë sektor janë të angazhuar shumica e fuqisë punëtore të Ndërmarrjes, në zonën e përfshirjes në rrjetin e mbledhjes së mbeturinave kemi të shpërndarë :

1	Kontinier të madhësisë 1.1 m ³	454
2	Kontinier të madhësisë 1.5. m ³	14
3	Kontenier te madhësisë 1.3 m ³	5
4	Kontinier 120 L	860
4	TOTALI	1333

Për arsye të dëmtimit dhe në pamundësi të blerjes së kontinjerve të ri të madhësis 1.1m³ jemi të detyruar ti largojmë nga tereni dhe të kalojmë në shërbimin derë me derë,në ato vënde ku kemi pas shërbim me kontinjer 1.1 m³.

Sasia e mbeturinave qe bartën në deponi është si vijon :

<u>1</u>	Ditore	43.32 m ³
<u>2</u>	Mujore	953.06 m ³
<u>3</u>	Vjetore	11436.8 m ³

Janë realizuar 292 ditë pune në vitini 2021 në mbledhjen e mbeturinave

Automjete

Në vitin 2021 kemi patur të angazhuar këto automjete :

- **4 (katër)** kamion për kontinier 1.1 m³ të gjith funksional (CALABREZE)viti i prodhimit 2000, (MITSUBISH) viti i prodhimit 2009 dhe (FORD) viti i prodhimit 2011, Mercedes 4.3 T viti i prodhimit 2004,
- **1** Kamion MERCEDES Automatik për kontenjer 1.1 m³ te cilin e ka blerë Komuna me një pjesmarrje nga “**Ambienti**” ,nga 20 Qershori është në funksion pasi i njeti ka qen defekt per një kohë te gjatë.
- **1** Kamion **Man** viti i prodhimit 2007 i bler me mjete vetanake në mujan Maj,vlera e blerjes **21,800 € ,paguar nga “Ambienti” Istog.**
- **1 (një)** kamion për kontinier të mdhej i viti i prodhimit 1989.
- **1(një)** Cisternë për bartje të ujit - FAP 14-14 viti i prodhimit 1989.
- **1 (një)** Kamionetë e vtit 2000.
- **1** Kamion transportues dhe,

- 1 Traktor për pastrim bore.

Deponia

Deponia në Tuqep është mirëmbajtë nga Janari deri në Prill nga firma “Sib” me pages nga Ambineti, nga Maj deponia mirëmbahet nga kompania e kontraktura nga komuna deri ne muajn Nëntor pasi ia ka ndërpre komuna kontraten. Nga muja Nëntor mirëmbahet nga firma “Sib” me pages nga Ambineti.

Të hyrat dhe Shpenzimet

Të hyrat e Ndermarrjes kryesisht kan qenë inkasimet qe bëhën për shërbimet qe u ofrojmë obliguesve tanë.

Shpenzimet e bëra edhe këtë vit si viteve të tjera janë kryesisht :

- për të ardhura personale të punëtorve ;
- për derivate të naftës qe janë pashmangshëm shumë të mëdha bazuar në aktivitetin qe e kryejmë ;
- mirëmbajtja dhe riparimet e automjeteve (shumica të vjetra)

Raporti i punës për vitin 2021

- Gjatë vitit 2021 është punuar sipas planit operativë për menaxhim të mbeturinave.
- Gjatë vitit 2021 kemi bërë shtrirjen e shërbimeve të reja në :

- 1.Veriqi
- 2.Veriqi i ri
- 3.Shalinivicë
- 4.Osjena
- 5.Kërrninë e ulet
- 6.Tuqep
- 7.Lluga te poshtem Staradran
- 8.Zhakovë
- 9.Cërkolez
- 10.Suhogërllë
- 11.Padalishtë

Pra numri i klientëve është rritur që do të thotë se edhe sasia e mbeturinave është rritur .

Në vazhdimësi kemi bërë fshirjen e trotuareve nëpër qytet dhe në të gjitha rrugët e qytetit, disa herë brenda muaji Kemi fshi rrugët edhe në bashkësitë lokale te Gurrakocit, dhe atë të Vrellës sipas nevojave,dhe atë pa pagesë nga **24.04.2021** pasi qe ka skaduar kontrata ,dhe anulimit te tenderit.

Kemi mirëmbajtur drunjët Dekorativ nëpër Qytet si dhe Parkun në Gurrakoc.

Njëherit kemi mirëmbajtur ambientin te Burimi i Istogut qe nga data **01.01/2018** deri me sot.

Në teren kemi bërë punë në sensibilizimin e popullatës për mbrojtje të ambientit dhe për obligimet qe ka popullata ndaj Ambientit.

Ende nuk është realizuar projekti nga GIZ-1 Prej shumës nga **146000** euro.

Ky raport është përfshinë në pika shumë të shkurtëra te aktivitetete kryesore të **Njësisë Operative “Ambienti” – Istog** për periudhën **Janar-Dhjetor 2021**.

Istog
21.01.2022

U.D Menaxher
Alferd Tahirsylaj